



Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës

RAPORT I PUNËS

**RAPORT I PUNËS SË MENAXHMENTIT TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË
GJATË PERIUDHËS KOHORE: 1 JANAR 2017 – 31 DHJETOR 2017**

AKTIVITETI NË SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE	2
Aktiviteti: Implementimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020	2
Aktiviteti: <i>Implementimi i rregullorës së punës së shefave të degëve dhe katedrave</i>	4
Aktiviteti: <i>Implementimi i udhëzuesit për punimin e temave të diplomës</i>	4
Aktiviteti: <i>Fillimi i reformave në vlerësimin e studentëve</i>	5
Aktiviteti: <i>Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë</i>	7
Aktiviteti: <i>Pranimi i studentëve në FM</i>	8
Aktiviteti: <i>Përmbyllja e procesit të zgjedhjes së stafit të angazhuar për vitin akademik 2017/2018</i>	8
Aktiviteti: <i>Rishikimi i rregullores për avancime dhe databazat e rekomanduara për publikime shkencore të stafit të Fakultetit të Mjekësisë</i>	9
Aktiviteti: <i>Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë</i>	11
Aktiviteti: <i>Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>	19
Aktiviteti: <i>Themelimi dhe funksionalizimi i e-Laboratorit</i>	21
Aktiviteti: <i>Pilotimi i Qendrës Informative të Barnave (QIB)</i>	23
Aktiviteti: <i>Themelimi Qendrës për Simulim dhe Zhvillim të Shkathtësive Klinike</i>	24
Aktiviteti: <i>Krijimi i grupit punues për aplikim në programin Erasmus</i>	26
Aktiviteti: <i>Vazhdimi i adresimit të integritetit akademik</i>	26
Aktiviteti: <i>Participimi i studentëve në procesin mësimorë</i>	27
Aktiviteti: <i>Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimorë</i>	29
Aktiviteti: <i>Përpilimi i raporteve F1, F2, F3</i>	31
Aktiviteti: <i>Evidentimi i publikimeve nga stafi i Fakultetit të Mjekësisë</i>	31
Aktiviteti: <i>Funksionalizimi i plotë i dokumentacionit në Google Drive</i>	32
Aktiviteti: <i>Ngritja e cilësisë në praktikën klinike të studentëve të viteve të fundit</i>	33
Aktiviteti: <i>Ceremonia e diplomimit të studentëve të Universitetit të Prishtinës</i>	35
AKTIVITETI NË SFERËN PROFESIONALE SHËNDETËSORE	36
Aktiviteti: <i>Takime pune me Drejtorin ekzekutiv të SHSKUK-se dhe Bordin e SHSKUK</i>	36
Aktiviteti: <i>Takime pune me Këshillin Drejtues të UP-ë dhe MSH</i>	36
Aktiviteti: <i>Organizimi i edukimit të vazhdueshëm profesional nga Fakulteti i Mjekësisë</i>	37
Aktiviteti: <i>Takime pune në kuader të Bordit Nacional për Kontroll të Kancerit (BNKK)</i>	37
Aktiviteti: <i>Pjesëmarrja e menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë në Simpoziume dhe Kongrese vendore dhe ndërkombetare</i>	39
AKTIVITETI NË SFERËN E INFRASTRUKTURËS DHE FINANCEVE	41
Aktiviteti: <i>Përmirësimi i infrastrukturës në Degën e Farmacisë</i>	41
Raporti i shpenzimit të Buxhetit të Fakultetit të Mjekësisë për vitin 2017	42
Shpenzimet e Fakultetit të Mjekësisë sipas kategorive	43
Investimet në infrastrukturën mësimore	47

AKTIVITETI NË SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE

Aktiviteti: Implementimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti i Fakultetit të Mjekësisë, në bashkëpunim me shefat e degëve, ka ndërmarrë një sërë aktivitete të drejtuara në implementimin e Strategjisë Zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020 (shih shtojcën). Në këtë aspekt, aktivitetet e vitit 2017, ishin të fokusara kryesisht rreth cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxenje, në përpilim të strategjive zhvillimore të katedrave të Fakultetit të Mjekësisë, në ndërkombëtarizimin e FM dhe në ngritjen e kapaciteteve kërkimoro-shkencore. Strategjia në fjalë ishte përpiluar me marrjen e detyres nga menaxhmenti i tanishëm, në vitin 2016. Kjo strategji është prezantuar para partnerëve ndërkombëtare me ç'rast ka marrur edhe vlerësime të larta.



Rezultatet fillestare të implementimit të strategjisë në vitin 2017:

- *Përpilimi i strategjive individuale të të gjitha Katedrave në FM*
- *Pranimi i studentëve në baza meritore dhe duke respektuar në plotësi kriteret e përcaktuara*
- *Kthimi i studentëve në ligjerata në numër sinjifikant*
- *Përmirësimi në cilësi të mësimdhënjes si pasojë e prezencës më të madhe të studentëve në ligjërata*
- *Realizimi dukshëm më i mirë i orëve akademike sipas planprogramit nga ana e mësimdhënësve*
- *Përmirësimi në sistemin e vlerësimeve të studentëve*
- *Përmirësimi në aspektin e adresimit të integritetit akademik*
- *Përmirësimi i infrasktrukturës në FM gjatë vitit 2017, sidomos në aspektin e mësimdhënjes*
- *Vazhdimi i ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Mjekësisë*
- *Mbështetja e inovacionit nëpërmjet krijimit të qendrave si: e-laboratori, qendra për simulim dhe zhvillim të aftësive klinike, si dhe kontributi thelbësorë në krijimin e Venture-UP*
- *Mbështetja dhe angazhimi në ngritjen e punës kërkimore në FM duke krijuar fillimisht databazën e tërë aktivitetit kërkimorë në FM*
- *Plotësimi i planprogrameve dhe syllabuseve të pasluftës, të cilat kishin gabime, sidomos teknike në kalkulim të orëve*
- *Pllotësimi i syllabuseve të munguara*
- *Përmirësimi i komunikimit të stafit dhe ngritja e efqiencës së raportimit nëpërmjet funksionalizimit të plotë të sistemit google-drive të komunikimit*
- *Akreditimi i programeve mësimore*
- *Bashkëpunimi me organizata profesionale me qëllim të rritjes së mundësive të studentëve tonë për të kryer punë praktike profesionale*
- *Funksionalizimi i trupit këshilldhënës të FM.*

Aktiviteti: Implementimi i rregullorës së punës së shefave të degëve dhe katedrave

Përshkrimi i aktivitetit: Gjatë vitit 2017 është bërë implementimi i rregullorës së punës së shefave të degëve dhe katedrave. Fillimisht u hasën në vështirësi në aspektin e marrjes së përgjegjësisve përkatëse nga bartësit, mirëpo shumica e këtyre vështirësive u tejkaluan me një bashkëpunim të ngushtë të menaxhmentit me shefat e degëve dhe katedrave. Në këtë aspekt, menaxhmenti ka zhvilluar takime të rregullta me shefat e degëve dhe katedrave sipas nevojës. Gjithashtu, shefat e degëve kanë organizuar takime me shefat e katedrave me qëllim të qartësimit të përgjegjësive që dalin nga rregullorja në fjalë. Rregullorja për punën e shefave të degëve dhe katedrave është përpiluar në vitin 2016, është e para e këtij lloji në Universitetin e Prishtinës, i cili ka miratuar këtë rregullore për FM në Senat. Kjo rregullore specifikon punën e shefave të degëve, katedrave dhe sekretarëve të katedrave dhe nga menaxhmenti i tanishëm i FM-së ishte cilësuar si një nevojë imediate për të përmirësuar funksionalizimin e Katedrave, si dhe për të ngritur efqiencën dhe llogaridhënjen në Fakultetin e Mjekësisë. Këto role nuk ishin të specifikuara më herët. Rrjedhimisht, rregullorja në fjalë ngrit edhe transparencën në punët e përditshme akademike në Fakultetin e Mjekësisë.

Rezultatet e pritshme: Fillimi i zbatimit të kësaj rregulloreje ka rezultuar në ngritje të efqiencës, efektivitetit dhe llogaridhënjes në të gjitha instancat menaxhuese të Fakultetit të Mjekësisë. Si rezultat, është ngritur niveli i monitorimit të mësimi dhe është përmirësuar raportimi i orëve nga ana e stafit akademik të FM-së.

Aktiviteti: Implementimi i udhëzuesit për punimin e temave të diplomës

Përshkrimi i aktivitetit: Gjatë vitit 2016, ishte hartuar udhëzuesi (shih shtojcën) që do të ndihmonte stafin dhe studentët në të gjitha procedurat që ndërlidhen me temën e diplomës, që nga zgjedhja e temës e deri te përfundimi i saj. Kjo erdhi edhe si pasoj e hyrjes në fuqi të temës së diplomës për degët e mjekësisë së përgjithshme dhe stomatologjisë, që rezultoi në një sfide administrative. Përkundër faktit që disa nga degët (infirmieri, fizioterapi, farmaci dhe mami) kishin sistemin e diplomimit të studentëve me temë të diplomës, një udhëzues i tillë mungonte në Fakultet. Gjatë vitit 2017, është implementuar udhëzuesi i temës së diplomës gjë që ka rezultuar në lehtësim të procedurave në këtë aspekt dhe gjithsesi ka

rezultuar në ngritje të cilësisë së temave diplomës, duke pasur parasysh se tanimë stafi dhe studentët kishin një minimum të standardeve që duhet respektuar.

Rezultatet e pritshme: Vazhdimi i implementimit të udhëzuesit të temave të diplomës do të ngrisë cilësinë e temave të diplomës që dorëzohen nga studentët, duke ofruar një rrugë të qartë për studentët dhe stafin se si duhet siguruar një standard minimal që duhet të plotësohet.

Aktiviteti: *Fillimi i reformave në vlerësimin e studentëve*

Përshkrimi i aktivitetit:

a) *Rubrikat e vlerësimit*

Gjatë vitit 2017 në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e cilësisë në punën që dorëzohet nga studentët, u identifikuar nevoja që specifikisht me rastin e dorëzimit dhe mbrojtjes së temave të diplomës të krijohet një standard i vlerësimit. Në këtë aspekt u dizajnuar sistemi i rubrikave të vlerësimit të temave të diplomës (shih shtojcën). Rubrika e vlerësimit është një instrument i dizajnuar nga Komisioni i Studimeve i Fakultetit të Mjekësisë. Kjo rubrikë është dizajnuar me qëllim të përcaktimit të kriterëve themelore gjatë vlerësimit të studentëve me rastin e prezantimit të punës së tyre seminarike apo me rastin e mbrojtjes së temave të diplomës. Ky sistem mundëson vendosjen e vlerës numerike në raport me përshkruesit specifik të performancës së studentëve dhe mundëson një llogaritje më objektive të poentimit dhe notimit të studentëve gjatë prezantimit të punës së tyre. Duke siguruar një uniformitet dhe standard ndërmjet vlerësuesve të ndryshëm të të njejtit student, rubrika e vlerësimit gjithashtu ndikon pozitivisht në aspektin e mbrojtjes së integritetit akademik gjatë procesit të vlerësimit të studentëve (shih shtojcën e bashkangjitur).

b) Vlerësimi i vazhdueshëm i studentëve dhe aplikimi i syllabuseve

Gjatë vitit akademik 2016/2017, janë shtuar aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e vlerësimit të vazhdueshëm në Fakultetin e Mjekësisë. Në këtë aspekt, duke u konsultuar edhe me zyren për zhvillim akademik të UP-së, menaxhmenti ka kërkuar nga Profesorët që të aplikojnë komponentet e vlerësimit të vazhdueshëm. Në rast se syllabuset përkatëse nuk e kanë paraparë vlerësimin e vazhdueshëm atëherë nga Profesorët e lëndëve është kërkuar që ti reformojnë ato dhe të përfshijnë komponentet e vlerësimit të vazhdueshëm gjatë vitit akademik. Një gjë e tillë është paraparë edhe me rekomandimet e Agjencise së Akreditimit dhe në përgjithësi nga rekomandimet që ndërlidhen me cilësinë në arsimin e lartë.

c) Dizajnimi i formularëve të vlerësimit

Me qëllim të monitorimit të vlerësimit të vazhdueshëm, si dhe me qëllim të ngritjes së nivelit të integritetit akademik, është dizajnuar formulari elektronik (shih shtojcën) që ju mundëson Profesorëve të lëndës të regjistrojnë të gjitha llojet e vlerësimeve që aplikohen si dhe ju mundëson regjistrimin e aplikimit të kriterëve kyqë që ndërlidhen me integritetin akademik gjatë procesit të vlerësimeve. Gjatë vitit akademik 2017 është implementuar ky formular, i cili gjithashtu i ka ndihmuar Dekanatit gjatë procesit të ankimimit të studentëve në lidhje me pakënaqësitë eventuale të studentëve me vlerësim (shih formularin në shtojcë).

d) Themelimi i Zyrës së Vlerësimeve

Menaxhmenti i FM është në proces të aplikimit për ardhjen e një specialisti Fulbright, me përvojë në themelimin e qendrave të vlerësimit të studentëve. Pra, FM planifikon që të pilotoj themelimin e një qendreje të tillë, në bashkëpunim me Rektoratin, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe përmirësimit të sistemit të vlerësimeve në FM dhe pastaj edhe në UP.

Rezultatet e pritshme: Aktivitetet e mësipërme synojnë të ngrisin nivelin e integritetit akademik në aspektin e vlerësimit të studentëve. Menaxhmenti i FM konsideron çështjen e

vlerësimeve si diçka që duhet të adresohet me prioritet, prandaj i ka ndërmarrur hapat e mësipërme, të cilët do të vazhdojnë së implementuari me qëllim të përmirësimit të cilësisë së vlerësimeve në Fakultetin e Mjekësisë dhe kështu gradualisht të arrihet tek eliminimi i kushteve për nevojën e afateve jo-statutore të provimeve.

Aktiviteti: Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Fakulteti i Mjekësisë pas akreditimit në programet si Mjekësi I Përgjithshme (deri në vitin 2021), Fizioterapi (deri në vitin 2019), Stomatologji (deri në vitin 2021), Farmaci (deri në vitin 2021), Infermieri (deri në vitin 2019), Mjekësi Praktike -PhD (deri në vitin 2021), Mjekësi Klinike-PhD (deri në vitin 2021), Stomatologji-PhD (deri në vitin 2021), Shëndet Publik-PhD (deri në vitin 2021) dhe Biomjekësi Eksperimentale (deri në vitin 2021); ka vazhduar me aktivitet për aplikim dhe akreditimit të programit të Mamisë për vitin akademik 2018/2019. Ndërkohë gjatë viti 2017, është akredituar edhe programi Edukimi në Kujdesin Shëndetësorë-MSc (deri në vitin 2020).

Rezultatet e pritshme: Procesi i akreditimit në përgjithësi (përveç mosakreditimit të programit të Mamisë) ka qenë pozitiv për Fakultetin e Mjekësisë, pasi që janë bërë edhe rekomandime, të cilët janë adresuar dhe të cilat rezultojnë në përmirësime konkrete në Fakultet.

Aktiviteti: *Pranimi i studentëve në FM*

Përshkrimi i aktivitetit: Për vitin akademik 2017/2018, Fakulteti i Mjekësisë ka përmbyllur me sukses procesin e regjistrimit të studentëve në nivelin e studimeve themelore, studimeve master dhe studimeve të doktoratës. Pranimi i studentëve, proces ky i cili historikisht ka kaluar nëpër faza të vështira në FM, edhe këtë vit është përfunduar me sukses nga ana e menaxhmentit të FM, duke respektuar në përpikshmëri udhëzimet dhe konkursin e shpallur nga Rektorati, si dhe duke respektuar rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Kjo ka vazhduar të kontribuoj pozitivisht në ngritjen dhe ruajtjen e kredibilitetit të FM në këtë proces. Kësaj here, kryetar i komisionit për pranimin e studentëve në studimet themelore ishte Prof Ass Dr Ilir Begolli, ndërsa kryetar i komisionit për pranimin e studentëve të doktoratës ishte Prof Dr Cen Bytyqi.

Rezultatet e pritshme: Përmbyllja e suksesshme e procesit të pranimi të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë për vitin akademik 2017/2018, vazhdon të kontribuoj në ndërtimin e reputacionit të Fakultetit të Mjekësisë për një proces meritore dhe duke respektuar kriteret e konkursit gjatë procesit të pranimi studentëve.

Aktiviteti: *Përmbyllja e procesit të zgjedhjes së stafit të angazhuar për vitin akademik 2017/2018*

Përshkrimi i aktivitetit: Procesi i zgjedhjes së stafit të angazhuar akademik në Fakultetin e Mjekësisë për vitin akademik 2017-2018 është përmbyllur me sukses. Në kuadër të konkursit për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, për herë të parë në vitet e fundit është kërkuar të respektohet Ligji i Shëndetësisë dhe të konsiderohet përvoja e specialistëve klinik.

Gjatë procesit të angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm, janë identifikuar edhe problemet, të cilat synojmë t'i evitojmë ose parandalojmë në konkurset e ardhshme. Për shëmbull, ky konkurs është hapur shumë vonë e që ka rezultuar në angazhim të vonuar të stafit akademik dhe rrjedhimisht ngecje të mësimin në disa katedra. Vonesa e konkursit ishte e ndërlidhur me shpalljen e vonshme të tij nga ana e Rektoratit ndërsa ngecja e mësimin në disa katedra është duke u kompenzuar nga stafi i angazhuar.

Rezultatet e pritshme: Menaxhmenti i FM-së synon të mirëmbajë transparencën në procesin e zgjedhjes së stafit akademik duke përfshirë këtu edhe sigurimin e përzgjedhjes së stafit në baza meritore. Kjo do të ndikojë pozitivisht në ndërtimin e mëtutjeshëm të reputacioni të Fakultetit të Mjekësisë si dhe ngritjes së kapaciteteve kadrovike në FM.

Aktiviteti: Rishikimi i rregullores për avancime dhe databizat e rekomanduara për publikime shkencore të stafit të Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Me rastin e iniciativës së Rektoratit të Universitetit të Prishtinës për të hartuar rregulloren e re për zgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik në Universitetin e Prishtinës, Këshilli Mësimorë-Shkencorë i Fakultetit të Mjekësisë propozoi që për stafin akademik të Fakultetit të Mjekësisë të vlejnjë databizat: Eeb of Science, Pubmed, Scopus dhe Scimago (që bazohet në Scopus). Këto databaza morën aprovimin unanimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë. Gjithashtu, në kuadër të rregullores së re për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik në FM, me iniciativën e menaxhmentit të FM-së, unanimit miratoi propozimin që në rastin e Fakultetit të Mjekësisë, për katedrën e kirurgjisë dhe mjekësisë interne të mirret parasysh profilizimi i stafit sipas klinikave të QKUK. Në këtë aspekt, në rastet kur pozita e re nuk mund të plotësohet me 50% e normës së plotë me ligjerata, atëherë në kuadër të normës të llogaritet dyfishi i orëve gjatë mësimdhënjes në lëndën e Praktikës Klinike të vitit 6, pra në raport 2:1 (sqarim shtesë në shkresën e dërguar në Rektorat). Kjo kërkesë nga menaxhmenti u arsyetua me faktin që kemi mjaft klinika të QKUK-së pa profesorë, janë pensionuar shumë profesorë që nuk janë zëvendësuar, ngritja e cilësisë së mësimdhënjes në lëmi specialistike të profilizuara, të cilat për momentin nuk kanë profesorë si dhe efekteve të përgjithshme pozitive që kjo do të ketë në QKUK dhe shëndetësinë kosovare në përgjithësi.

Në kuadër të rregullores në fjalë, dhe për të adresuar problemin e katedrave paraklinike dhe shqetësimet e ngritura nga shefat e këtyre katedrave në aspektin kadrovik, Këshilli i FM-së gjithashtu propozoi që në lëndët paraklinike specializimi nuk është i domosdoshëm. Nëqoftëse kandidati që konkuron në lëndët paraklinike ka specializim, atëherë vlerësimi i atij specializimi të bëhet në pajtueshmëri me specializimet e përafërta të përcaktuara nga katedra përkatëse paraklinike dhe në harmoni me kërkesat e katedrës përkatëse.

Rezultatet e pritshme: Specifikimi i databazave të rekomanduara për publikime shkencore pritet që të mbështesë stafin akademik në procesin e identifikimit të revistave shkencore prestigjioze për të publikuar. Gjithashtu, një specifikim i tillë do të ngrisë cilësinë e publikime në Fakultetin e Mjekësisë. Kërkesat e mësipërme në aspektin kadrovik, nëse aprovohen, do të kenë efekte pozitive si në aspektin akademik, ashtu edhe në atë shëndetësorë.

Aktiviteti: Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Siq është specifikuar edhe në strategjinë zhvillimore, ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësië është një nga prioritetet kyqe të menaxhmentit të ri. Në këtë aspekt, menaxhmenti i ri ka realizuar këto aktivitete konkrete:

- Janë ndarë çertifikata dy anëtareve të Bordit Ndërkombëtarë Këshillues të Nderit gjatë konferencës ndërkombëtare për kancerin e Prostatës të organizuar nga Fakulteti i Mjekësisë: Prof. Bob Djavan nga Universiteti Mjekësor i Vienës në Austri dhe Prof. Ates Kadioglu nga Fakulteti i Mjekësisë së Universitetit të Stambollit.



- Në Prill të vitit 2017 Dekanati organizoi përzgjedhjen e kandidatit shkëmbimin studentorë me Geisel School of Medicine. Në kuadër të këtyre aktiviteteve për herë të parë që nga bashkëpunimi 15 vjeçarë në fushën e shkëmbimit të

studentëve më këtë Universitet prestigjioz, Dekanati organizoi poentifikimin e detajuar të kandidatëve gjatë intervistimit të tyre (shih shtojcën). Kjo rezultoi në një proces transparent që në të njejtën kohë siguroi edhe përzgjedhjen e kandidatit më të mirë. Për këtë proces të përzgjedhjes Dekanati u vlerësua lartë nga drejtuesit e Geisel School of Medicine. Format i dizajnuar me këtë rast, do t'i shërbejë Fakultetit të Mjekësisë në të ardhmën për të bërë përzgjedhjen e studentëve gjatë shkëmbimeve ndërkombëtare.

- Inicimi i bashkëpunimit me Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit Linkoping të Suedisë, në aspekt të shkëmbimit të stafit akademik për hulumtime shkencore dhe bashkmentorim të doktorantëve, zhvillim të programeve të infermierisë dhe sidomos në avancimin e qendrës për simulim dhe zhvillim të shkathtësive klinike meqë, Fakulteti i Mjekësisë së Universitetit Linkoping është lider në këtë fushë dhe në këtë drejtim realizimi i një projekti të përbashkët për këtë qëllim për të aplikuar për fonde në programin Erasmus + të KE.






- Vizitë e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Stambollit për të inicuar bashkepunimin në aspekt të realizimit të edukimit të vazhdueshëm profesional mjekësor në klinikat e tyre, me qëllim të avancimit të shkathtësive në teknikat bashkëkohore të sofistikuara mjekësore të fushave të ndryshme mjekësore, të cilat nuk realizohen në Kosovë. Takim me Dekanin e Fakultetit të Mjekësisë, Rektorin dhe Akademikun Gabor Hamza nga Hungaria.



- Vizitë e Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Zagrebit në kuadër të 100 vjetorit të themelimit të tij





Vizitë qendrës për simulim dhe zhvillim të shkathtësive klinike të Fakultetit të Stomatologjisë të Universitetit të Zagrebit

- Vizite Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Shkupit në kuader të 70 vjetorit të themelimit të tij



Në kuadër të programit Open World Leadership të Ambasadës Amerikane në Kosovë, Prodekani i Fakultetit të Mjekësisë vizitoi disa Universitet Amerikane duke përfshirë: University of Neë York, Columbia University, Cornell-Tech, Mercy College, University of Albany, Leaman College, City College New York. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me sistemin universitar amerikan. Me këtë rast, Prodekani u takua me udhëheqësit e Universiteteve të mësipërme dhe u njoftua mbi praktikatat më të avancuara në sistemin terciarë të edukimit amerikan, sidomos me praktikatat, të cilat do të implementoheshin në Kosovë. Në kuadër të këtyre vizitave, gjithashtu u dakordua që Profesorët e ndryshëm nga Universitetet e

sipërcekura të ndihmojnë FM nëpërmjet disponueshmërisë së tyre për të mbajtur ëëbinare për studentët e FM-së.



Fakulteti i Mjekësisë ishte pjesë e Konferencës së organizuar nga asociacioni Pharmaceutical Care Network Europe, të organizuar në Bled të Sllovenisë në Shkurt 2017. Gjatë kësaj konference Prodekani i Fakultetit prezantoi kapacitetin kërkimorë të Degës së Farmacisë para Asamblesë së Përgjithshme të këtij asociacioni dhe u arrit që Fakulteti i Mjekësisë, pra Katedra e Praktikës së Farmacisë dhe Kujdesit Farmaceutik të bëhet anëtarë me të drejta të plota i këtij asociacioni. Ky është një asociacion prestigjioz evropian i lëmisë së Farmacisë, sidomos në aspektin kërkimorë dhe ky anëtarësim pritët të facilitoj kapacitetet e studimeve të doktoraturës në Degën e Farmacisë, studime të cilat janë planifikuar të akreditoohen këtë vit.



New member from Prishtina

Department of Pharmacy Practice and Pharmaceutical care is one of the newest departments of the Pharmacy Division, Faculty of Medicine, University of Prishtina, Kosovo. This department was established with the view of strengthening formal education of pharmacy students in this field as well as advancing research in the area of pharmacy practice. The Division of Pharmacy, established in 1996, is conveniently located within the University Clinical Centre of Kosovo (UCCK), an approximately 3000 bed hospital which provides ample opportunity for research in the area of pharmacy practice in hospital setting especially. Led by Ass. Prof. Kreshnik Hoti, the department is currently focused on a number of pharmacy practice based research projects. Namely, medication reconciliation at admission and discharge point, antibiotic self-medication, prescriber behaviour driving complementary medicines' use, effects of poor health literacy on medication management and use of mobile devices in facilitating medication management and the management of chronic are some of the key areas of interest. Furthermore, the team is this year due to start a study assessing patients' quality of life, pre-and-following coronary artery bypass grafting surgery, as affected by medication used. Given the co-location with other health professionals at the UCCK, the department is also interested in exploring models of promoting pharmacists' integration into interprofessional practice, through utilizing their medication review skills.



Menaxhmenti i FM, siq edhe është cekur në strategjinë zhvillimore, ka filluar aktivizimin e alumnit kosovarë dhe të diasporës që punon në punon në Universitete ndërkombëtare dhe sektorin shëndetësorë. Në këtë aspekt janë organizuar disa vizita dhe ligjerata nga bashkëatdhetarët tonë si për shembull ligjerata nga Dr A. Dreshaj nga SHBA, në lëminë e Psikiatrisë, Dr Emir Hoti nga Irlanda, në lëminë e kirurgjisë hepatobiliare, Prof Hasa nga Anglia në lëminë e Farmacisë etj. Në këtë aspekt, Fakulteti planifikon të organizojë vizita mujore, ligjerata dhe punëtori nga alumnit ndërkombëtarë dhe ekspertët akademik dhe shëndetësorë të diasporës. Gjithashtu vlen të theksohet edhe ligjerata nga ana e Prof Terry Bard nga Harvard University, nga American Unit of UNESCO në fushën e Bioetikës.

Rezultatet e pritshme: Intensifikimi i ndërkombëtarizimit Fakultetit të Mjekësisë pritet që të ngrisë në mënyrë sinjifikante aktivitetet mësimore dhe kërkimore të stafit tonë akademik dhe studentëve në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare. Aktivitetet e mësipërme gjithashtu mundësojnë shkëmbimin më të lehtë të studentëve në mënyrë që të kenë mundësi më të mira për tu njohur me praktikat ndërkombëtare.

Aktiviteti: *Marrëveshjet e bashkëpunimit*

Përshkrimi i aktivitetit: Në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare dhe atyre lokale, menaxhmenti i FM gjatë kësaj periudhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa organizata profesionale që pritet të ketë efekt pozitiv në mbarëvajtjen e procesit mësimorë në FM dhe në ngritjen e mëtutjeshme të kapaciteteve dhe ofrimit më të mirë të kushteve për studentët tonë. Përvec organizatave të ndryshme profesionale, marrëveshje bashkëpunimi u arrit edhe me Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Linkopinit (sic u cek më lartë), si dhe me Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Podgoricës në Mal të Zi. Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e këtyre aktiviteteve.

- Nenshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Podgoricës në Malin e Zi në aspekt të shkëmbimit të stafit akademik, bashkëmentorimit të doktoranteve dhe specializanteve të fushave të ndryshme specialistike.
- Nenshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Fondacionin Aksioni për Nënë dhe Fëmijë për të realizuar praktikë të studenteve të drejtimit të infermierisë dhe mamisë në kuadër të projekteve të tyre në teren.



- Nenshkrimi i marreveshjes së bashkepunimit me Fondacionin KOMC për të realizuar edukimin e vazhdueshem profesional ne fushen e ultratingullit.



Rezultatet e pritshme: Marrëveshjet e mësipërme pritet të rezultojnë në përmirësime konkrete në mësimdhënjen dhe mësimnxënjen në Fakultetin e Mjekësisë. Konkretisht, me organizatat profesionale, marrëveshjet pritet të kenë efekte pozitive ne edukimin e vazhdueshë profesional dhe sidomos në fushat e intermierisë dhe mamisë, për të cilat menaxhmenti i FM-së është duke u munduar të ngrisë kapacitetet, ndërsa nga marrëveshjet me Universitetin e Linkopinit dhe atë të Podgoricës, pritet të përfitojnë edhe degët tjera të FM-së.

Aktiviteti: Themelimi dhe funksionalizimi i e-Laboratorit

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti ka themeluar e-laboratorin për herë të parë në Fakultetin e Mjekësisë. Në këtë aspekt, janë duke u përdorur softverë që asistojnë edukimin, e-learning dhe module të edukimit nga distanca, smart-boards, që facilitojnë interaksionin gjatë procesit mësimorë, si dhe softverë për verifikimin e plagjiaturës. Ky e-laborator do të zhvillohet vazhdimisht dhe është në dispozicion për të gjithë studentët e Fakultetit të Mjekësisë, si dhe shërben për mësimdhënje për lëndët që shfrytëzojnë një teknologji të tillë.

Rezultatet e pritshme: E-laboratori do të ofroj mundësinë për të:

- shfrytëzuar softverë të ndryshëm që do të asistojnë mësimin e studentëve dhe performancën e tyre akademike.
- shfrytëzuar softverin kundër plagjiarizmit për të ruajtur integritetin akademik.
- stimuluar angazhimin e studentëve dhe ruajtjes së mësimnxënjes
- ofruar material mësimor interaktiv
- qasur në mënyrë më efektive dhe më e lehtë në databaza të ndryshme
- të integruar më mirë alumni tonë që punojnë në institucione ndërkombëtare
- ofruar trajnim të vazhdueshëm të stafit tonë akademik në komponente të ndryshme të mësimdhënjes dhe vlerësimit.

Gjithashtu, e-laboratori do të mbështesë procesin e fillimit të ndërtimit të komponenteve online të lëndëve në programe të ndryshme të FM dhe kështu arihet mbështetja konkrete e facilitimit të bashkëpunimit me staf akademik dhe Universitete ndërkombëtare.

Më poshtë janë disa fotografi që ilustrojnë momente nga themelimi i e-laboratorit:





Vlen të theksohet se e-laboratori ka filluar së punuari dhe në të janë duke u organizuar aktivitete të ndryshme inovative nga ana e Profesorëve dhe Asistentëve të FM-së. Në këtë aspekt, përvec ushtrimeve më interaktive që janë duke u zhvilluar në e-laborator, këtu janë organizuar ëëbinare të ndryshme me Profesor nga Franca, Anglia dhe vende të tjera jashtë Kosovës.

Më poshtë janë paraqitur disa momente nga webinarët e organizuar në e-Laborator me ligjeruesit nga lëmitë e infermierisë nga Anglia, Universiteti Derbit, David Robertshaw dhe Prof Dritan Hasa nga De Monfort University Leicester ne Angli, n .





Aktiviteti: Pilotimi i Qendrës Informative të Barnave (QIB)

Përshkrimi i aktivitetit: Sic është cekur edhe në raportin e vitit të kaluar, Fakulteti i Mjekësisë ka marrë iniciatiën e themelimit të Qendrës Informative të Barnave (QIB). Kjo është e para QIB në Kosovë dhe misioni parësorë i kësaj qendreje është që të sigurohet përdorimi racional i barnave, minimizimi i problemeve nga barnat dhe reduktimi i pranimeve në spital që janë rezultat i përdorimit jo të drejtë të barnave. Gjatë vitit 2017, në kuadër të realizimit të këtij projekti me interes nacional, Dekanati ka realizuar këto aktivitete:

- ka realizuar takime të ndryshme dhe është koordinuar me SHSKUK-në në lidhje themelimin e QIB
- ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit, në bashkëpunim me Rektoratin e UP-së, me Drejtorin e SHSKUK-së
- ka filluar implementimin e projekt propozimit të dizajnuar gjatë vitit 2016
- ka filluar pilotimin e QIB-së që parashihet në memorandumin e nënshkruar

- ka caktuar stafin përbërës të Task Forcës që parashihet në kuadër të memorandumit
- ka ndarë lokacionin ku stafi do të punoj në kuadër të QIB-së
- ka komunikuar me QIB tjera në Amerikë dhe Gjermani, për të bashkëpunuar në aspektin e ngritjes së kapaciteteve të QIB-së. Në këtë aspekt, janë organizuar takime me përfaqësues nga Universiteti i Floridës, si dhe është komunikuar me Prodekanin e Duquesne University në Pittsburgh. Pritet që këto komunikime të rezultojnë me vizita specialistike të stafit të këtyre qendrave në QIB tonë për të ndihmuar në ngritjen e kësaj qendreje. Në këtë aspekt, FM është në process të aplikimit në programin Fulbright specialist të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Rezultatet e pritshme: QIB do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e shëndetit publik që ndërlidhet me përdorimin e barnave. Gjithashtu, QIB do të ndikoj pozitivisht në avancimin e aktiviteteve që ndërlidhen me mësimnxënjen dhe mësimdhënjen rreth barnave. Gjithashtu, do të siguroj një shfrytëzim më të mirë të ekspertizës që për momentin është në dispozicion në degën e Farmacisë dhe katedrën e Farmakologjisë. QIB do të përmirësojë bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet Fakultetit dhe Klinikave të QKUK, do të përmirësoj sigurinë dhe mirëqenjen e pacientëve rreth barnave, si dhe do të mbështesë klinikistët në QKUK në lidhje me informimin profesional dhe të pavarur mbi barnat


Aktiviteti: *Themelimi Qendrës për Simulim dhe Zhvillim të Shkathtësive Klinike*

Përshkrimi i aktivitetit: Në Janar të viti 2018, Fakultetit Mjekësisë me fonde vetanake të UP-së, inauguroi qendrën për simulim dhe zhvillim të shkathtësive klinike – qendër e parë e këtij lloji në Kosovë. Qëllimet e themelimit të kësaj qendreje, duke u bazuar edhe në strategjinë e zhvillimit të FM-së, janë që të përmirësohet mësimdhënja dhe mësimnxënja e shkathtësive klinike duke simuluar ambiente reale, që u mundëson studentëve të ushtrojnë teknika të ndryshme klinike në modele trupore, para se ata të angazhohen në praktikën klinike me pacientë të vërtetë. Kjo do të jetë hera e parë që studentët e Fakultetit të Mjekësisë do të fillojnë të mësojnë në ambient të realitetit të simuluar. Prandaj, Qendra për Simulim dhe Zhvillim të Shkathtësive Klinike do të ofrojë resurse të vlefshme fizike dhe edukative që

facilitojnë procesin e mësimnxënjes së shkathtesive klinike

Rezultatet e pritshme: Përmirësim të performancës së studentëve dhe reduktim të ankthit të studentëve para së ata të praktikojnë në pacientë të vërtetë; Studentët arrijnë një nivel të kënaqshëm të konfidencës dhe profiqiencës bazike para punës dhe procedurave me pacientë real; Përmirësim i sigurisë së pacientëve dhe mirëqenjes së tyre; Mbushja e zbrazëtirës ndërmjet mëimit teorik dhe praktikës klinike

Fotot më poshtë janë nga Qendra për Simulim dhe Zhvillim të Aftësive Klinike





Aktiviteti: Krijimi i grupit punues për aplikim në programin Erasmus+

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmetni i Fakultetit të Mjekësisë është duke u munduar që të ngris kapacitetet në kuadër të aplikimit në grantet që janë në dispozicion. Me këtë rast është formuar grupi punues specifik për aplikim në projektet Erasmus të radhës. Ky grup është funksionalizuar dhe pritet që të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme, të vij me projekte konkrete dhe të aplikojë në rrethin e radhës së programit Erasmus +.

Rezultatet e pritshme: Tërheqja e fondeve për zhvillim të Fakultetit të Mjekësisë, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe aktivitetit kërkimorë dhe numrit të publikimeve si rezultatet e përmirësimit të kushteve me rastin e marrjes së granteve përkatëse.

Aktiviteti: Vazhdimi i adresimit të integritetit akademik

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti i FM ka vazhduar të ndërmarrë aktivitetet konkrete me qëllim të adresimit të integritetit akademik në FM. Në këtë aspekt, menaxhmenti ka adresuar edhe strategjinë zhvillimore 2016-2020, e cila i kushton një rëndësi të veçantë çështjes së integritetit akademik. Siç edhe është cekur më lartë, aktivitetet që janë ndërmarrur gjatë vitit 2017 për adresuar integritetin akademik janë ndërlidhurar kryesisht me reformat vlerësimit të drejtë të studentëve, regjistrimit të notimit të studentëve dhe moderimit të vlerësimeve, krijimi i standardeve dhe uniformimit të vlerësimit të temave të diplomës (pra rubrikat e vlerësimit), respektimi dhe implementimi i udhëzimit për përpilimin e temës së diplomës,

monitorimi aktiv i procesit të mëimit, aktivitetet që ndërlidhen me kthimin e studentëve në ligjerata. Menaxhmenti e parashih këtë si proces gradual që do të implementohet plotësisht, sipas praktikave ndërkombëtare brenda periudhës katërvjeçare siq parashihet në strategjinë zhvillimore të Fakultetit.

Rezultatet e pritshme: Siç edhe është cekur më herët, adresimi i Integritetit akademik do të afrojë Fakultetin e Mjekësisë me praktikën ndërkombëtare, do të ndikojë pozitivisht në reputacionin e Fakultetit dhe do të ngrisë cilësinë e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në Fakultetin e Mjekësisë.


Aktiviteti: *Participimi i studentëve në procesin mësimorë*

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti i FM ka identifikuar problematikën e mosvijimit të studentëve në ligjerata, praktikë kjo që ka vazhduar të cenoj procesin mësimorë në FM që nga periudha e pasluftës. Për të adresuar këtë problematikë, në kuadër të aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënjes dhe mësimnxënjes, menaxhmenti (duke përfshirë shefat e degëve dhe katedrave) kanë pasur konsultime dhe takime duke përfshirë edhe takime të rregullta me studentë dhe përfaqësues të tyre, pra Këshillim e Studentëve. Gjatë këtyre takimeve, kryesisht me intensitet të shtuar në semestrin verorë 2017, menaxhmenti është takuar, së bashku me përfaqësues të Këshillit të studentëve, edhe me përfaqësuesit e viteve përkatëse të studentëve të çdo dege në FM. Me këtë rast studentët vazhdimisht kanë qenë të inkurajuar që të marrin pjesë në ligjerata si dhe janë informuar në lidhje me pasojat eventuale. Me përfundimin e vitit akademik, në Qershor 2017, stafit akademik i është kërkuar të mos ju lejojnë hyrjen në provim të studentëve të cilët nuk kanë vijuar ligjeratat. Kjo ka shkaktuar edhe ngritje të seriozitetit me rastin e fillimit të vitit të ri akademik 2017/2018.

Për të vlerësuar impaktin e këtyre aktiviteteve, Dekanati së bashku me katedrat ka kryer një vlerësim të gjendjes ku janë zgjedhur në mënyrë të randomizuar 27 lëndë obligative në të gjitha degët e FM-së. Nga katedrat përkatëse është kërkuar që për secilën lëndë të dërgojnë vijimin e studentëve në ligjerata gjatë katër javëve të muajit Tetor, për vitet 2017, 2016, 2014 dhe 2013 – bazuar në regjistrimet në librat amzë që janë në dispozicion në sallat e ligjeratave.

Në vitin 2017, nga rezultatet u vërejtë një rritje e rëndësishme në vijueshmërinë e studentëve në ligjerata.

Figura 1, ilustron këtë rritje.



Rritjen më të lartë e shënuan lëndët kyqe klinike si: Propedeutika e Mjekësisë Interne, Mjekësia Urgjente, Gjinekologjia, Pediatria si dhe Mikrobiologjia. Në tabelën 1 janë të paraqitura më shumë detaje sipas lëndëve të zgjedhura në mënyrë të randomizuar për këtë vlerësim.

TABELA 1: VIJUESHMERIE E STUDENTEVE NE LIGJERATA

Java e Tetorit:	J1	J2	J3	J4	J1	J2	J3	J4	J1	J2	J3	J4	J1	J2	J3	J4
Lenda/Viti	17	17	17	17	16	16	16	16	15	15	15	15	14	14	14	14
Paradontologji	5	31	43	42	0	0	50	79	22	77	85	45	0	0	0	0
Mjekesi Oral	5	39	51	36	0	73	82	50	27	83	98	23	0	0	0	0
Mjekesi urgjente	84	230	55	201	0	0	66	50	0	49	59	32	0	0	0	0
Biokimi klinike (F)	6	32	32	23	0	24	41	33	15	30	54	46	0	0	0	0
Biokimi klinike (MP)	75	127	153	153	40	124	105	82	66	105	128	105	0	0	0	0
Mjekesi Fizikale me Rehabilitim	70	145	182	137	0	0	55	39	0	12	6	36	0	0	0	5
Anatomi (MP)	55	68	72	72	2	83	0	0	41	57	59	45	0	0	0	0
Anatomi (ST)	38	68	69	72	28	42	16	13	0	0	0	0	0	0	0	0
Oftalmologji	13	75	104	90	0	0	44	39	0	44	36	49	0	0	0	0

Teknologji Farmaceutike	19	60	57	67	0	30	44	30	0	0	40	20	0	0	0	0
Analize dhe Kontroll i Barnave	15	33	35	35	0	5	24	8	0	0	12	11	0	0	0	0
Propedeutike e Mjekesise Interne	102	185	206	200	0	50	79	54	9	34	24	18	0	0	0	36
Farmakognozi	9	35	33	40	0	25	59	58	7	33	53	51	0	0	0	0
Informatike farmaceutike	16	45	53	61	0	12	39	30	0	0	12	0	0	0	0	0
Pediatri (MP)	34	143	115	241	0	0	0	0	0	20	16	11	0	0	0	0
Pediatri (ST)	7	57	100	85	0	0	0	0	0	34	0	0	0	0	0	0
Neurologji	33	82	109	177	0	51	47	36	0	0	0	31	0	0	0	0
Neurologji ne Fizioterapi	29	36	43	44	0	21	33	36	0	0	0	0	0	0	0	0
Mikrobiologji mjekesore	107	188	203	225	0	30	67	56	4	46	83	0	106	147	160	231
Gjinekologji me Obstetrikë	43	168	224	230	0	58	26	31	0	30	44	31	0	0	0	7
Statistike mjek. me informatike (Ft)	13	22	23	21	9	46	50	47	0	32	38	36	0	0	0	0
Statistike mjek. me informatike (F)	43	52	53	51	0	45	45	46	0	0	0	0	0	0	0	0
Ortopedi per Fizioterapi	41	40	32	40	0	23	18	31	0	0	21	34	0	0	0	0
Protetike dhe Ortotike (ft)	45	29	37	45	0	27	21	31	0	0	18	36	0	0	0	0
	116	163	180	159	136	59	186	112	142	186	140	0	0	0	0	0
Stomatologji Restaurative	29	66	62	74	14	17	40	34	0	24	72	48	0	0	0	0
Semundjet e Dhembit me Endodoncion	5	32	42	43	0	0	41	38	9	26	68	43	0	0	0	0
Kirurgji orale	21	85	91	89	15	89	89	90	29	85	96	94	30	73	75	76

Nga Tabela 1 gjithashtu mund të vërehet si FM ka arritur që për herë të parë të filloj mësimin në ligjerata qysh në javën e parë të Tetorit në shumicën dërmuese të lëndëve (në këtë mostër të gjitha lëndët ka filluar ligjeratat qysh në javën e parë.

Aktiviteti: Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimorë

Përshkrimi i aktivitetit:

a) aktivitetet rreth monitorimit të mësimit

Gjatë semestrit verorë të vitit 2017, përkatësisht në muajin Maj, FM është audituar nga auditori i brendshëm. Me këtë rast, auditori ka dhënë rekomandime konkrete muajin Qershor 2017, në aspektin e përmirësimit të procesit të monitorimit të procesit mësimorë dhe raportimit të orëve të mbajtura. Në aspektin e përmirësimit të raportimit, rekomandimet ndërlidheshin edhe me raportimet jo të plota (p.sh. mungesa e titujve të njësive mësimore, mungesa e nënshkrimeve etj.) në raportet mujore të orëve. Ky auditim ishte bërë për

periudhen 2015, 2016 deri në Prill të vitit 2017. Në atë kohë, FM kishte ndërmarrur aktivitete konkrete në përmirësimin e monitorimit të mësimit ku dhe kishte identifikuar nevojën e ridizajnit të monitorimit dhe raportimit të procesit mësimorë duke deleguar dhe specifikuar detyrat edhe tek shefat e degëve, katedrave dhe sekretarëve përkatës. Në këtë aspekt gjithashtu, edhe ishin ridizajnuar edhe formularët e raportimit për të mbështetur këtë proces.

Menaxhmenti gjatë periudhës së vitit 2017 përveç ridizajnit të formulareve të raportimit mujor, ndërmorri edhe një hap tjetër duke filluar kështu implementimin e sistemit dyjavorë të raportimit të monitorimit të mësimit nga ana e katedrave (shih shtojcën). Kjo ka rezultuar në një azhurnim më të lartë të katedrave në këtë aspekt.

Pastaj, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e auditorit të brendshëm për përmirësimin e procesit të monitorimit të mësimit, menaxhmenti i FM krijoi **ekipet mobile të monitorimit** të mësimit (shih shtojcën), duke ngritur kështu nivelin e monitorimit të mësimit dhe duke rritur përgjegjësinë e Profesorëve të të gjitha degëve. U krijuar 5 ekipe të ndryshme mobile për semestrin dimërorë të vitit akademik 2017/2018, ku secili ekip përmban 2 Profesorë të degëve të ndryshme, një asistent dhe një përfaqësues të Keshillit të studentëve. Këto ekipe janë obliguar të auditojnë në mënyrë të randomizuar së paku 2 herë në javë në të gjitha degët pa dallim. Ekipet do të ndërrohet në semestrin verorë për të siguruar kështu një shpërndarje më të mirë të llogaridhënjes dhe përgjegjësi tek stafi. Në këtë aspekt, vlenë të theksohet se pritet implementimi i ID kartelave për monitorim të mësimit, gjë që do të ndihmonte shumë procesin e monitorimit të mësimit.

Rritja e numrit të studentëve nëpër ligjerata ka ndikuar në një mbarëvajtje më të rregullt të procesit mësimorë nga ana e Profesorëve. Kjo konkretisht ka rezultuar në një realizim më të plotë të orëve nga ana e stafit akademik.

b) Fillimi i vitit akademik 2017/2018

Viti akademik 2017/2018 ka filluar në mënyrë rekorde duke u relizuar mësimi qysh nga dita e parë e semestrit pra 2 Tetori 2017. Kjo është bërë e mundur falë një mobilizimi intensive të Dekanatit, Shefave të Degëve dhe Sekretarëve të Degëve në përpilimin e orarit para fillimit të

mësimit si dhe nga ana e administratës në aspektin e regjistrimit të studentëve me kohë dhe finalizimit me kohë të grupeve të studentëve.

Rezultatet e pritshme: Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimorë ka shënuar progres të rëndësishëm gjatë vitit 2017. Në baza mujore është identifikuar dhe proceduar stafi që nuk ka mbajtur mësimin dhe në përgjithësi ka rezultuar në një mbarëvajtje më të mirë të mësimit. Kjo është duke ndodhur falë aktivizimit të të gjitha strukturave menaxhuese të Fakultetit, duke përfshirë Dekanatin, shefat e degëve, katedrave dhe sekretarëve përkatës.

Aktiviteti: Përpilimi i raporteve F1, F2, F3

Përshkrimi i aktivitetit: Procesi i përpilimit të raporteve F1,2,3 është përmbyllur me sukses nga ana e Dekanatit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha katedrat. Gjatë këtij procesi, janë konsultuar individualisht shefat e katedrave përkatëse me ç'rast janë finalizuar raportet e orëve të stafit akademik për vitin akademik 2017/2018.

Rezultatet e pritshme: Raportimi i sakt i orëve në formularët F1, F2 dhe F3 siguron një pasqyre më të saktë të angazhimit të stafit. Kjo është esenciale dhe siguron një planifikim më të mirë kadrovik, përkatësisht zhvillim dhe planifikim kadrovik më afat-gjatë të Fakultetit të Mjekësisë.

Aktiviteti: Evidentimi i publikimeve nga stafi i Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Në Nëntor të vitit 2017 ka filluar evidentimi i plotë fillimisht i artikujve shkencorë të stafit të Fakultetit të Mjekësisë. Ky aktivitet i inicuar nga menaxhmenti dhe udhëhequr nga Koordinatori për Kërkime në Fakultetin e Mjekësisë, është përmbyllur me sukses duke krijuar kështu databazën e parë që pasqyron gjendjet e publikimeve në Fakultetin e Mjekësisë. Nga ky evidentim i parë që është bërë rezulton se stafi i FM ka gjithsej 869 punime, prej të cilave 735 janë me autor i parë (ose korrespondent) nga FM dhe 134 punime janë në bashkëpunim me institucione jashtë vendit. Viti 2017 shënon vitin ku stafi i FM-së ka publikuar më së shumti me gjithsej 106 punime. Nga 3 degët më të mëdha në FM, rezulton që dega MP ka gjithsej 574 punime, dega Stomatologjisë ka gjithsej 93 punime ndërsa në degën e Farmacisë janë identifikuar gjithsej 94 punime. Llogaritur në aspektin e stafit në këto

degë, rezulton që dega Farmacisë ka një koeficient më të lartë (totali i stafit pjesëtuar me totalin e punimeve) pra 6.0, në krahasim me degën e MP me koeficient 3.8 dhe degën e Stomatologjisë me koeficient 2.1. Llogaritja e punimeve në këtë databazë është preliminare dhe nuk paraqet llogaritjen finale të artikujve shkencorë, meqenëse një raportim i plotë ende është duke u reviduar dhe finalizuar.

Rezultatet e pritshme: Evidentimi i numrit të publikeve në FM, mundëson analiza më të mira të gjendjes faktike dhe i mundësoj FM-së të evidentojë hapësirat ku ka nevoj për më shumë aktivitete me qëllim të përmirësimit të aktivitetit kërkimorë në FM. Për shembull nga raporti i mësipërm preliminarë, del se ekziston një trend në rritje në numrin e publikeve të stafit të FM-së mirëpo vërehet një nevoj që stafi i FM-së të krijoj më shumë bashkëpunime ndërkombëtare, pasi që kjo do të ndikojë pozitivisht edhe në ndërkombëtarizimin e FM-së.

Aktiviteti: *Funksionalizimi i plotë i dokumentacionit në Google Drive*


Përshkrimi i aktivitetit: Gjatë vitit 2017 është përmbyllur organizimi i procesit të kyqjes së katedrave të Fakultetit në sistemin google-drive. Për të arritur këtë, janë organizuar takime edhe me sekretarët dhe shefat e katedrave. Aplikimi i këtij sistemi, të dizajnuar në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorin për Zhvillim, ka rezultuar në komunikim më efektiv ndërmjet Dekanatit, Koordinatorit për Zhvillim Akademik, Shefave të Degëve, Shefave të Katedrave, si dhe Sekretarëve të Degëve dhe Katedrave përkatëse. Tani çdo katedër e ka folderin e vet në google-drive dhe raportimi që kërkohet nga shefat e degëve dhe Dekanati bëhet nëpërmjet këtij sistemi.

Rezultatet e pritshme: Aktivitetet e mësipërme kanë mundësuar një komunikim më të mirë si dhe një rifreskim të vazhdueshëm të dokumentacionit që kërkohet. Kjo ka lehtësuar në

mënyrë thelbësore proceset si raportimi orëve, rizgjedhja e stafit, kontratat e stafit, procesin e akreditimit etj.

Aktiviteti: *Ngritja e cilësisë në praktikën klinike të studentëve të viteve të fundit*

Përshkrimi i aktivitetit: Gjatë vitit 2017, menaxhmenti identifikoi problematikën e realizimit dhe evidentimit të përvojës së studentëve në lëndët e praktikës klinike të viteve të fundit. Fillimisht kjo u identifikuar tek studentët e Farmacisë në lëndën Praktika në Barnatore. Me fjalë të tjera, në këtë lëndë por edhe në praktikat tjera klinike të viteve të fundit, sidomos në degën e Mjekësisë së Përgjithshme, ka munguar një sistem më cilësor i evidentimit të punës që kryhet në këto lëndë. Në këtë aspekt, duke filluar nga Dega e Farmacisë, Komisioni ka aprovuar praktikumin që do të bëjë evidentimin e praktikës së studentëve në barnatoret përkatëse. Komisioni për studime pastaj shqyrtoj mundësinë që një sistem i ngjajshëm, por natyrisht me specifikat përkatëse të lëndeve klinike dhe katedrave të bëhet edhe për studentët e degës së Mjekësisë së Përgjithshme. Me këtë rast, Komisioni ngarkoi shefën e Degës së MP Prof Asoc Isme Humolli që, duke u bazuar edhe në praktikën e Degës së Farmacisë, të dizajnoj sistemin e evidentimit të praktikës klinike në MP duke futur në funksion praktikumin përkatës.



Rezultatet e pritshme: Evidentimi më i mirë i praktikës klinike të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë do të kontribuoj pozitivisht në përvojën klinike të tyre dhe në arritjen më të plotë të shkathtësive dhe kompetencave përkatëse klinike.

Aktiviteti: *Ceremonia e diplomimit të studentëve të Universitetit të Prishtinës*

Përshkrimi i aktivitetit: Fakulteti i Mjekësisë morri pjesë në ceremoninë e promovimit të doktorantëve të Fakultetit të Mjekësisë.



Rezultatet e pritshme: Ceremonia e diplomimit të organizohet edhe me tutje duke avancuar formatin e ceremonisë.

AKTIVITETI NË SFERËN PROFESIONALE SHËNDETËSORE

Aktiviteti: Takime pune me Drejtorin ekzekutiv të SHSKUK-se dhe Bordin e SHSKUK

Pershkrimi i aktivitetit: Gjatë takimeve janë diskutuara shumë çështje lidhur me aktivitetet edukative të Fakultetit të Mjekësisë në Klinikat e QKUK-se si:

- përzgjedhjen e drejtorëve të klinikave dhe instituteve;
- pilotimin e qendrës informative të barnave;
- problemet infrastrukturore
- interpretime ligjore
- rregullimi i çështjes së kartelave
- uzurpimi i hapësirave të dedikuara për studentet dhe stafin akademik;
- harmonizimit të interesave të FM dhe SHSKUK-së etj...

Rezultatet e pritshme: Bashkëpunimi i mirëfilltë dhe thellimi i intergrimit të edukimit shëndetësor me kujdesin shëndetësor, duke rezultuar në avancimin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në lëndët klinike, që ka për synim ngritjen e kompetencave të të diplomuarve nga Fakulteti i Mjekësisë dhe më tutje ofrimi i një kujdesi më të mirë shëndetësor në Kosovë.

Aktiviteti: Takime pune me Këshillin Drejtues të UP-ë dhe MSH

Pershkrimi i aktivitetit: Gjatë takimeve janë diskutuar çështjet që ndërlidhen me kompenzimin e pagave për drejtorët e Klinikave të QKUK-së si dhe me MSH në lidhje me korigjimin e udhëzimit administrativ për specializime dhe subspecializime. Për më shumë detaje referojuni shtojcës përkatëse.

Aktiviteti: *Organizimi i edukimit te vazhdueshëm profesional nga Fakulteti i Mjekësisë*

With the view of increasing the funding and improving conditions which will help us with improve our research performance, the new management has recently established a Working Group for Projects and Donations. This group which is comprised of our academic staff, will be supported in gradually strengthening its capacities and will lead the innovation and training of the rest of our staff in relation to various research and project-based activities.

3) Teaching and research infrastructure

The Faculty of Medicine is currently located at the University Clinical Centre campus. Our vision is to ensure that our students and academic staff have the necessary infrastructural basis and equipment which will enable them to have an excellent teaching and research experience. It is acknowledged that this is an area which requires significant investments in order to reach a world-class capacity and level.

In this regard, the new management has already identified a number of acute areas requiring improvement in existing infrastructure. Our strategy is to seek funding from various international donors in order to improve our teaching and research infrastructure. Within the next four years, we expect that through various projects and donations (facilitated by the abovementioned working group) this will be achieved. Additionally, our strategy is that for the first time, the Faculty of Medicine actively engages with industry partners (pharmaceutical and other medical partners), with the view of obtaining required support that will enable us to make the necessary infrastructural improvements.

Within the next four years, our vision is to have the:

- new building of Deanery completed (currently under construction and expected to be completed by 2017),
- complete the building of the new School of Pharmacy building
- complete the building of laboratory animal facility

The above infrastructural projects are expected to significantly improve the teaching and research infrastructure at the Faculty of Medicine. Furthermore, the Faculty of Medicine will be focusing on also improving the administrative infrastructure by optimizing the use of technology in daily administrative activities, improve communication between staff and students as well as ongoing updating of our website. This is expected to result in better staff, student and third party satisfaction rates.

4) Internationalization of the Faculty of Medicine

One of our key priorities is the internationalization of the Faculty of Medicine. In this regard, we are strategically focused on improving and developing international partnerships with four main stakeholders:

- World-class Universities
- International alumni working in international institutions
- Albanian diaspora working in international Universities and health sector
- International donors focused on educational programs (EU, USAID etc.)

Within the next four years, we aim to significantly improve the international outlook of the Faculty of Medicine by closely collaborating with world class Universities. IN this regard, the new management has already established communications and collaboration with a number of international institutions including: Geisel School of Medicine (Dartmouth, US), St Vincent University Hospital, University of Derby (UK), Linköping University (Sweden), Curtin University (Australia). These collaborations are expected to result in projects which will advance our teaching and learning as well as research capacity over the next four years. We aim to expand the list of international Universities that we collaborate with.

To achieve internationalization of the Faculty of Medicine, the new management has planned active engagement of Kosovo's alumni working in international institutions and Albanian diaspora working in international Universities and health sector. The plan is to establish Visiting Professor and Adjunct Professor roles within the Faculty that will see an active engagement of international experts at the Faculty of Medicine. In this regard, the Faculty has planned monthly visits, lectures and workshops by international alumni and diaspora health and academic experts. These visits are expected to result in significant increase in engagement of teaching and research related activities of our academic staff and students with best international opportunities and practices.

To further achieve and facilitate internationalization, the Faculty of Medicine has recently established an International Experts Honorary Board, comprising of leading Professors from Western Europe, US and Australia. This board is expected to provide advice and facilitate the internationalization of the Faculty of Medicine.

Functional Independence

In order to fulfill the key priorities of the above vision of the Faculty of Medicine, a functional independence of the Faculty of Medicine from the University of Prishtina is required. This necessity stems from a number of reasons and activities which the Faculty of Medicine cannot currently perform as a result of centralization of these competencies at central levels of the University. The key reasons for which functional independence of the Faculty of Medicine needed are listed below:

- Ability to reach international agreements which will facilitate internationalization of the Faculty of Medicine
- Ability to independently apply and manage EU available funding which will stimulate and better manage EU based projects
- Introduce rules and regulations which pertain specifically to medical fields, that are not recognised in the current legislation of the University
- Increase the quality threshold and requirements in relation to staff's key performance index given that the Faculty of Medicine currently has the academic staff capacity for such an important step

The above functional independence is required in order to achieve a much needed improvement in Faculty's international outlook, Kosovo's Health care, becoming regionally and internationally competitive in medical education as well as with the view of our Faculty producing world-class health professionals.

It is worth emphasizing that a functional independence of the Faculty of Medicine was also recommended by international accreditation experts during the most recent audit of our undergraduate and post-graduate experts.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Prof. dr. Marjan Dema

Rektor i Universitetit të Prishtinës

Nr. Prot.: 3974

Datë: 14/12/2016

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e datës 14.10.2016, mori këtë

V E N D I M


- I. Miratohet Rregullorja për Shefa të Katedrave dhe Shefave të Degëve në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë Rregullorja e Punës së Shefave të Katedrave dhe Shefave të Degëve në Fakultetin e Mjekësisë.
- III. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një rregulloreje e cila përcaktohen kriteret e domosdoshme për organizimin e punës dhe detyrat e Shefave të Katedrave dhe Degëve në Fakultetin e Mjekësisë, që të ofrojnë arsimim akademik, kërkime shkencore e shëndetësore, si dhe kushtet organizimi dhe realizimi e këtyre kriterëve të përcaktuar si në Rregullore, gjithnjë brenda kornizave të akteve ligjore dhe nënligjore, Senati i Universitetit të Prishtinës, një zëri, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi t'u dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Zyrtarit ligjor të UP-së;
5. Arkivit të UP-së.



Prof. Marjan Dema

Rektorit të UP-së



Universiteti i Prishtinës
"Hasan Prishtina"

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISTINENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-512223 Mail: mjekesia@uni-pr.edu

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I MJKËSISË
PRISHTINË

Pranuar me:	15.04.2016		
Nr.:	Nr.:	Shtojca	Vlera
	2975		

Ref. nr.

Prishtinë,

/2016

Rregullorja e Punës së Shefave të Katedrave dhe Shefave të Degëve në Fakultetin e Mjekësisë

Dispozitat e përgjithshme

Rregullore për punën e shefave të katedrave dhe shefave të degëve në Fakultetin e Mjekësisë
Dispozitat e përgjithshme Me këtë Rregullore përcaktohen punët dhe detyrat e punës për shefat e degëve dhe shefat e katedrave në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Fakulteti i Mjekësisë (në tekstin e mëtejshëm: Fakulteti) është themeluar më 17 qershor 1969 ("Gazeta zyrtare e KSAK" nr. 20/69). Fakulteti ofron arsimim akademik, kërkime shkencore dhe shërbime shëndetësore.

Neni 1

Fakulteti e ka vulën e vet. Fakulteti mban emblemën dhe emrin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" brenda emblemës dhe emrit të vet.

Neni 2

Fakulteti është njësi akademike në kuadër të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë. Fakulteti ka këto qëllime:

1. Të veprojë si qendër universitare për edukimin e kuadrove shëndetësore, të krijojë kushtet për studime shkencore, të krijojë kuadro universitare dhe të ofrojë shërbime shëndetësore.
2. Të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimeve shkencore, si dhe ta çojë më tej kërkimin e së vërtetës shkencore dhe të mençurisë.
3. Të shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase.
4. Të bashkëpunojë dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet arsimore, hulumtuese dhe shëndetësore, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.
5. T'i përvetësojë dhe respektojë standardet evropiane.

6. Të ofrojë edukimin mjekësor themelor, specialistik dhe të vazhdueshëm profesional.
7. Të integrohet plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë dhe në zonën evropiane të kërkimeve shkencore si dhe të ndërmer hapa reformues të nevojshëm për arritjen e këtij objekti.

Neni 3

Fakulteti bën pjesë në zonën integruese evropiane dhe botërore të ofrimit të arsimit të lartë, të hulumtimeve shkencore në fushën e biomjekësisë dhe zotohet të respektojë të gjitha rregullat, standardet dhe përgjegjësitë që dalin nga marrëveshjet dhe të drejtat statutare e ligjore në këtë fushë. Neni 4 Fakulteti obligohet të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi në bazë të gjinisë, moshës, statusit fizik e mendor, racës, gjuhës, religjionit, përkatësisë politike, përkatësisë kombëtare, etnike e sociale.

Neni 4

Të gjithë individët dhe organet e Fakultetit do të sillen në përputhje me standardet më të larta të përkushtimit, integritetit, objektivitetit, përgjegjësisë, sinqeritetit dhe ndershmërisë. I gjithë personeli gjatë gjithë kohës duhet të veprojë vetëm në interes të Fakultetit si tërësi.

Neni 5

Personeli arsimor, shëndetësor dhe studentët e Fakultetit gëzojnë lirinë e bashkimit dhe të shprehjes brenda strukturave të parapara me këtë Rregullore, me Statutin e Universitetit dhe me Ligjin mbi Arsimin e Lartë.

Neni 6

Fakulteti është i organizuar në disiplina akademike të: 1. Aftësisit profesional; 2. Arsimimit akademik; 3. Kërkimit shkencor; 4. Aktiviteteve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe me akte tjera normative në fuqi.

Neni 7

Fakulteti ofron studime të rregullta themelore dhe studime pasdiplomike universitare. Neni 9 Komisioni i studimeve themelore i Fakultetit të Mjekësisë, duke iu referuar punës së shefave të katedrave dhe shefave të degëve, mund t'i propozojë Dekanit të formojë

nënkomisione për: 1. Kontroll, vlerësim dhe cilësi të mësimi; 2. Ankesa dhe parashtresa të studentëve.

Neni 8

Katedrat e Fakultetit të Mjekësisë janë si në vijim:

1. Lëndët paramjekësore (Kimi, Biologji, Biofizikë, Gjuhë Shqipe, Gjuhë Angleze)
2. Anatomi
3. Fiziologji dhe Immunologji
4. Biokimi dhe Biokimi Klinike
5. Farmakologji me Toksikologji dhe Farmakologji Klinike
6. Anatomi Patologjike dhe Histologji me Embriologji
7. Fiziologji Patologjike
8. Mjekësi Interne
9. Mikrobiologji
10. Sëmundjet infektive
11. Neurologji dhe Psikiatri
12. Pediatri dhe Gjenetikë Mjekësore
13. Kirurgji dhe Ndihma e Parë
14. Ortopedi
15. Anesteziologji me Reanimacion dhe Urgjenca Mjekësore
16. Oftalmologji
17. Otorinolaringologji (ORL)
18. Gjinekologji me Obstetrikë
19. Higjienë
20. Epidemiologji
21. Mjekësi Sociale, Mjekësi e Punës dhe Mjekësi Familjare
22. Mjekësi Fizikale me Rehabilitim
23. Sëmundjet e Dhëmbit
24. Protetikë Stomatologjike
25. Ortodonci, Pedodonci,
26. Parodontologji dhe Mjekësi Orale
27. Kirurgji Maksilo-Faciale dhe Kirurgji Orale
28. Dermatovenerologji

29. Radiologji
30. Onkologji me Radioterapi, Mjekësi Nukleare
31. Mjekësi Ligjore
32. Kimi Farmaceutike
33. Analiza e Kontrollit të Barnave dhe Teknologjia Farmaceutike
34. Praktika e Farmacisë dhe Kujdesi Farmaceutik
35. Kimi Toksikologjike dhe Bromatologji

Neni 9

1. Themelimi i katedrës është i mundur kur ekzistojnë së paku dy profesorë të lëmit përkatës dhe personelit mbështetës nga radha e asistentëve.
2. Katedrën e përbëjnë të gjithë mësimdhënësit dhe asistentët e rregullt.
3. Katedra ka shefin, zëvendësshefin dhe sekretarin.
4. Katedra është njësi organizative themelore e punës mësimore në fakultet. Numri dhe emërtimi i katedrave përcaktohet me këtë rregullore.
5. Katedra e ka për detyrë të zbatojë dhe të harmonizojë mësimin universitar dhe pasuniversitar, të kujdeset për përparimin e të gjitha formave të mësimit, mbi zgjedhjen dhe avansimin e kuadrove të angazhuar në procesin mësimor dhe për të gjitha çështjet tjera që janë të lidhura me efikasitetin e mësimit.

Neni 10

1. Me katedër udhëheq Shefi i katedrës, i cili drejton punën mësimore, shkencore dhe profesionale të katedrës.
2. Shefin e katedrës e propozon katedra dhe e zgjedh Këshilli i Fakultetit.

Neni 11

Mandati i shefit të katedrës zgjatë katër vjet d.m.th. aq sa zgjatë mandati i dekanit dhe prodekanëve siç parashihet në Statutin e UP-së. Shefi i katedrës përgatit, fton dhe udhëheq mbledhjen e katedrës. Kujdeset për ecurinë dhe cilësinë e veprimtarisë arsimore. Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Fakultetit. Shefin e katedrës e ndihmojnë zëvendësi dhe sekretari i katedrës. Zëvendësi dhe sekretari i katedrës zgjidhet me procedurë të njëjtë sikurse shefi i katedrës. Katedra mban mbledhje së paku dy herë në muaj. Pjesëmarrja në mbledhjen e katedrës është e detyrueshme për të gjithë anëtarët e

katedrës. Në mbledhjen e katedrës sekretari mban procesverbalin, një kopje e procesverbalit mbetet në arkiv, ndërsa një kopje tjetër i dorëzohet sekretarit të Fakultetit dhe prodekanit për mësim, pasi të jetë vërtetuar. Vendimet në katedër merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Neni 12

Detyrat e Shefit të Katedrës:

1. Të koordinojë dhe monitorojë punën e stafit akademik brenda katedrës.
2. Të mbajë takime të vazhdueshme me stafin akademik të katedrës.
3. Të përgatis dhe propozojë tek shefi i Degës strategjinë zhvillimore të Katedrës të ndërlidhur me resurset humane, resurset materiale dhe planin e hartimit të teksteve dhe literaturës për studentë.
4. Të monitorojë ambientet mësimore (amfiteatrot, sallat, laboratorët) që janë në përgjegjësi të katedrës.
5. Të informojë Shefin e Degës së paku 1 muaj para fillimit të semestrit, në lidhje me gatishmërinë për të filluar dhe realizuar procesin mësimor për lëndët që mbulohen nga katedra.
6. Të informojë Shefin e Degës lidhur me realizimin e programit mësimor, problemet me të cilat ballafaqohet dega dhe të japë propozime për zgjedhjen e tyre.
7. Të informojë Shefin e Degës në lidhje me mungesën eventuale të personelit akademik nga procesi mësimor.
8. Të mbikëqyrë rifreskimin dhe zbatimin e syllabuseve të lëndëve përbrenda katedrës.
9. Shefi i katedrës i mbikëqyrë ditarët e lëndëve, protokollet e notave dhe dokumentacionin tjetër që mbahen në katedrën përkatëse.
10. Shefi i Katedrës informon shefin e Degës për çdo afat të provimeve se fletëparaqitjet janë dorëzuar me kohë të shërbimet administrative përkatëse të Fakultetit.
11. Planifikon dhe dorëzon te shefi i Degës planin për stafin akademik të nevojshëm për realizimin e procesit mësimor për lëndët që i mbulon katedra.
12. Shefi i katedrës është përgjegjës për përgatitjen dhe verifikimin e dokumentacionit të lëndëve mësimore për akreditim dhe riakreditim të programeve sipas kërkesës së menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë.

13. E parashtron te Shefi i Degës, planifikimin për personelin akademik dhe joakademik të nevojshëm për punën e katedrës.
14. Në fillim të vitit akademik kërkohet të jetë i përditësuar dokumentacioni i personelit akademik (CV, syllabuset dhe dokumentacioni tjetër).
15. Në marrëveshje me personelin akademik të katedrës përcakton orarin e konsultimeve me studentë dhe sigurohet që informacioni të jetë i arritshëm për studentët.
16. Është përgjegjës për verifikimin dhe konfirmimin e orëve mujore të realizuara dhe të raportuara nga personali akademik i katedrës përkatëse.
17. Shefi i Katedrës obligohet që pas verifikimit dhe nënshkrimit, raportet e realizimit mujor të procesit mësimor t'i dorëzojë te Shefi i Degës.
18. Në rast të mungesës së Shefit të Katedrës, detyrat dhe obligimet i kalojnë zëvendësit të Shefit të Katedrës.

Neni 13

Detyrat e sekretarit të Katedrës:

1. Të mbajë procesverbalin e mbledhjeve të katedrës dhe arkivimin e tyre.
2. Sipas kërkesës së Shefit të Katedrës asiston në përgatitjen e materialit të Katedrës të nevojshëm për procesin e akreditimit dhe riakreditimit të programeve mësimore.
3. Sipas kërkesës së Shefit të Katedrës përgatit dhe përditëson listën e punimeve shkencore, pjesëmarrjet në konferenca shkencore dhe listën e projekteve shkencore të personelit akademik.
4. Është përgjegjës për mbajtjen e evidencave të vijueshmërisë ditore të cilat ia prezanton shefit të Katedrës për nënshkrim.
5. Sipas kërkesës së Shefit të Katedrës asiston në përgatitjen e materialit të Katedrës të nevojshëm për procesin e akreditimit dhe riakreditimit të programeve mësimore dhe kryen aktivitete tjera sipas kërkesës së Shefit të Katedrës.

Neni 14

1. Katedra harmonizon mësimin e të gjitha bazave mësimore brenda programit dhe planit mësimor të studimeve universitare.
2. Për koordinimin e ecurisë mësimore për lëndët që mësimin e mbajnë dy ose më shumë katedra formohet grupi punues nga përfaqësuesit e atyre katedrave.

3. Katedra, në koordinim më Shefin e Degës, i propozon Këshillit të Fakultetit nevojën për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e mësimeve dhe asistentëve.
4. Propozon ngritjen profesionale dhe shkencore të kuadrit të katedrës.

Neni 15

Lëndët të cilat nuk përfshihen në kuadër të katedrës mund të formojnë Këshillin e lëndëve. Këshilli i lëndëve është këshill profesional për koordinimin dhe zbatimin e mësimit të atyre lëndëve. Këshilli i lëndëve përbëhet nga mësimeve dhe asistentëve të atyre lëndëve. Udhëheqësi i këshillit është koordinatori i punëve të cilin e zgjedhë Këshilli i Fakultetit në propozim të mësimeve dhe asistentëve të lëndëve në mandat katërvjeçar.

Neni 16

Degët kanë programet dhe planet e tyre të mëvetësishme të studimeve themelore dhe pasdiplomike, të cilat veprojnë në kuadër të fakultetit si tërësi organike. Degët e studimeve themelore të Fakultetit të Mjekësisë janë:

1. Mjekësi e Përgjithshme
2. Stomatologji
3. Farmaci
4. Fizioterapi
5. Infermieri
6. Mami

Neni 17

Secila degë e Fakultetit të Mjekësisë duhet ta ketë shefin dhe sekretarin e degës.

Neni 18

1. Degën e udhëheq Shefi i Degës.
2. Shef i Degës mund të zgjidhet mësimeve dhe asistentëve me thirrje shkencore mësimore i cili shquhet në punën shkencore dhe organizative.
3. Shefin e degës e propozon Dekani, ndërsa e zgjedh Këshilli i Fakultetit.
4. Mandati i shefit zgjat katër vjet, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Neni 19

Detyrat e Shefit të Degës:

1. Të koordinojë dhe monitorojë punën e katedrave përbrenda degës.
2. Të përgatisë strategjinë zhvillimore të degës dhe ta rifreskojë atë strategji së paku çdo dy vjet
3. Të monitorojë ambientet mësimore (amfiteatrot, sallat, laboratorët).
4. Të informojë Dekanin, përkatësisht Prodekanin për çështje akademike lidhur me realizimin e programit mësimor, problemet me të cilat ballafaqohet dega dhe të japë propozime për zgjidhjen e tyre.
5. Shefi i Degës organizon takime me shefat e katedrave së paku dy herë brenda semestrit, sipas nevojës takimet mund të mbahen edhe më shpesh.
6. Shefi i Degës i mbikëqyrë ditarët e lëndëve që mbahen në degën përkatëse.
7. Është përgjegjës për përgatitjen dhe verifikimin e dokumentacionit për akreditim dhe riakreditim të programeve.
8. Është përgjegjës për konfirmimin e orëve mujore të raportuara nga shefat e katedrave përkatëse.
9. Në koordinim me shefat e katedrave, planifikon dhe prezanton te Dekani, përkatësisht Prodekani për çështje akademike, personelin akademik dhe joakademik të nevojshëm për punën e degës së studimit.

Neni 20

Të mbahet protokoll i për vijueshmërinë e studentëve në ligjërata dhe seminare, evidenca për vijueshmërinë në pjesën praktike të mësimit dhe protokoll i kryesor i provimit.

Neni 21

Mësimi teorik, seminarët dhe pjesa praktike e mësimit duhet të fillojnë dhe mbarojnë sipas orarit zyrtar të shpallur nga shërbimi përkatës. Katedra obligohet për realizimin e plan-programit, për mirëvajtjen e mësimit dhe të provimeve.

Neni 22

Mësimdhënësit i përgjigjen shefit të katedrës për realizimin e plan-programit dhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e mësimit dhe mbajtjen e provimit. Shefi i Katedrës i përgjigjet shefit të Degës dhe Prodekanit për mësim, Dekanit si dhe Këshillit të Fakultetit.

Neni 23


Shefi i Katedrës duhet ta informojë me shkrim shefin e Degës lidhur me përfundimin e mësimit nga lëndët mësimore përkatëse, me analizë të vijueshmërisë dhe shkallës së kalueshmërisë së studentëve si dhe të angazhimit të kuadrit mësimor në realizimin e plan-programit.

Neni 24

Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar dhe paraparë me këtë rregullore merret për bazë rregullorja e studimeve themelore, Statuti i UP-së dhe aktet normative në fuqi. Plotësimi dhe ndryshimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas mënyrës së miratimit. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë dhe Senati i UP-së. Me rastin e miratimit të kësaj rregulloreje obligohen shefat e degëve dhe të katedrave për zbatimin e saj.

DEKANE

Prof. dr. Suzana Manxhuka-Kërliu





Confidential Document

Interview Guide for students applying for the **Dartmouth Exchange Program**

Faculty of Medicine
University of Prishtina
10th of May 2017

Interview instructions:

- The duration of the student interview should be no longer than **10** minutes. It is important that the same amount of time is available for each student.
- Prior to the interview, the students should be briefed about the interview process.
- The interview is conducted in ENGLISH language.
- Each student is to be marked based on documentation submitted, which includes their CV, fulfilment of key criteria determined by the Panel and recommended by Dartmouth, as well as questions used during the interview.
- Panel members will mark the student in two sections, section A (which includes documentation submitted by candidates) and section B (which includes specific mainly behavioural questions for the candidate)
- Each panel member must mark the student independently.
- At the end of each interview, marks are compared with other panel members and a final score is calculated.
- Please ensure NO copies of the interview are handed to students or left unaccounted for.
- Thank you very much for your help.

Student:

Section A	
Candidates' key characteristics*	Marks
Students' CV (active conference participation-local oral =3) vs poster =1), active conference participation-international (oral =5 vs poster =3), student activities =2, project experience = 2, voluntary experience= 2, exchange programs=5)	_____/20
Comment:	
Students' academic performance (>8 grade average) 0.1 for each grade point	_____/20
Comment:	
Completion of relevant units Gynaecology, Paediatrics 6=2; 7=4; 8=6; 9=8; 10=10	_____/20 (10+10)
Comment:	
Total Marks in Section A	

*Please note the student must be in years five or six of academic study program at the Faculty of Medicine, General Medicine

Section B	
Please rate the student based on below scoring system: Poor = 1; Fair =2; Good = 3; Very good = 4; Excellent = 5	
Teamwork	
During your tutorial and practice work with other students, tell us specifically what have you done to show that you are a good team player	
Poor = 2 ☐ ; Fair 4 ☐ ; Good = 6 ☐ ; Very good = 8 ☐ ; Excellent = 10 ☐	
Comment:	
Adaptability	
Tell us why do you think you are the best candidate for Dartmouth exchange program and do you think you could adapt well in the US	
Poor = 2 ☐ ; Fair =4 ☐ ; Good = 6 ☐ ; Very good = 8 ☐ ; Excellent = 10 ☐	
Comment:	
Passion in Mother and Child care	
Tell us about your interest and passion in Mother and Child care area	
Poor = 2 ☐ ; Fair =4 ☐ ; Good = 6 ☐ ; Very good = 8 ☐ ; Excellent = 10 ☐	
Comment:	
Knowledge about Dartmouth	
Tell us what you know about Dartmouth Medical School and what are your expectations from this exchange program	
Poor = 2 ☐ ; Fair =4 ☐ ; Good = 6 ☐ ; Very good = 8 ☐ ; Excellent = 10 ☐	
Comment:	
Total Marks in Section B:	
Total Marks in Section A and Section B:	

Interviewer 1 Total Marks in Section A and Section B	
Interviewer 2 Total Marks in Section A and Section B	
Interviewer 3 Total Marks in Section A and Section B	
Interviewer 4 Total Marks in Section A and Section B	
Total Final Marks in Section A and Section B:	
Interviewer Name: _____	
Interviewer Signature: _____	



Confidentiality Statement

Deklaratë e Konfidencialitetit

I _____, hereby morally and legally declare that will NOT disclose nor discuss any information to any parties regarding the interview including questions during the Dartmouth Exchange Program interview until the end of interviews today at 2PM.

Unë _____, moralisht dhe ligjërisht deklaroj që NUK do të zbuloj ose diskutoj asnjë informacion tek asnjë palë në lidhje me intervistën ose pyetjet gjatë intervistimit për Programin Dartmouth të Këmbimit deri në përfundimin e procesit të intervistimit në ora 14:00.

Name/Emri: _____

Signature/Nënshkrimi: _____

Prishtinë, 10.05.2017

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Mjekësisë



**UDHËZUES PËR HARTIMIN E PUNITIT TË TEMËS SË
DIPLOMËS PËR STUDIME THEMELORE**

Prishtinë, Maj 2016

Përmbajtja

VËREJTJE TË PËRGJITHSHME	3
Përzgjedhja e temave dhe lloji i tyre	3
Dorëzimi dhe mbrojtja e Temës së Diplomës.....	4
UDHËZIMET TEKNIKE PËR HARTIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS	4
ILUSTRIMET.....	5
SHKURTESAT	5
LIDHJA DHE KOPERTINAT	5
FAQET HYRËSE	6
STRUKTURA E PUNIMIT TË DIPLOMËS	7
INTEGRITETI AKADEMIK.....	7
Mbledhja e të dhënave.....	7
Plagjiarizmi	8
Literatura	8

VËREJTJE TË PËRGJITHSHME

Temat e Diplomës duhet të propozohen nga të gjithë mësimdhënësit e Fakultetit të Mjekësisë. Çdo mësimdhënës duhet të propozoj deri në tetë tema për punimin e diplomës. Shefat e Katedrës duhet të paraqesin propozimin e Temave të Diplomës nga stafi akademik i katedrës përkatëse në fillim të çdo viti shkollor dhe sipas kërkesës së Menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë edhe në periudha tjera.

Vlerësimin e temave të propozuara e bënë Komisioni për Studime Themelore. Duke u bazuar në këto sugjerime dhe vlerësimin e bërë, realizohet regjistrimi i temave për punim diplome të cilat publikohen në faqet e internetit të Fakultetit të Mjekësisë dhe në tabelat e shpalljeve të fakultetit dhe katedrave përkatëse. Bankën e temave të katedrës përkatëse e monitoron shefi i katedrës.

Përzgjedhja e temave dhe lloji i tyre

Studentët nga programet e studimeve themelore (*të integruara dhe bachelor*) fillojnë procedurat për identifikimin e temës dhe mentorit potencial në vitin e fundit të studimeve. Kushti për përzgjedhjen e temës së diplomës është minus 3 provime nga viti i fundit i studimeve. Paraprakisht, studentët duhet të marrin vërtetimin për përmbushjen e këtij kushti nga Shërbimi i Studentëve. Studentët fillojnë procedurat e zyrtarizimit të temës vetëm pas përfundimit të provimit të fundit në kuadër të planprogramit të studimit përkatës.

Kohëzgjatja e përfundimit të temës së diplomës duhet të jetë jo më shumë se 3 muaj nga data e zyrtarizimit të temës. Në raste të caktuara kur studenti nuk ka arritur të përfundoj obligimet për përfundimin e temës për shkaqe shëndetësore ose shkaqe tjera të arsyeshme për të cilat pajtohen kandidati dhe mentorin, atëherë me një arsyetim në formë të shkruar mund të zgjatet edhe për një periudhë maksimale 3 muaj. Në rastet e udhëtimit jashtë vendit për kryerjen e komponenteve të caktuara të Temës së Diplomës, duhet të mirret leja paraprake nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë, para fillimit të punimeve rreth Temës së Diplomës.

Llojet e studimeve në kuadër të Temave të Diplomës mund të jenë:

- *hulumtimet kërkimore-shkencore*
- *rishikimet e literaturës*
- *studimet e rastit*

Dorëzimi dhe mbrojtja e Temës së Diplomës

Punimi i përfunduar i diplomës duhet të dorëzohet në 3 kopje të lidhura tek Shërbimi i Studentëve ndërsa kopja elektronike e temës finale duhet të dorëzohet tek Koordinatori për Cilësi i Fakultetit të Mjekësisë.

Pas pëlqimit të mentorit për gadishmërinë e kandidatit për mbrojtjen e Temës së Diplomës, mbrojtja e temës duhet të bëhet brenda 1 jave pas përfundimit të procedurave përkatëse administrative tek Shërbimi i Studentëve.

Komisioni vlerësues i punimit të Temës së Diplomës përbëhet nga tre anëtarë (kryetari dhe dy anëtarë). Njëri nga anëtarët e komisionit është mentori i kandidatit. Kryetari i komisionit koordinon punën e komisionit dhe nuk duhet të jetë mentori i kandidatit. Anëtarët e tjerë të komisionit i propozon Shefi i Katedrës duke marrë parasysh fushën e aktivitetit shkencor-profesional të Profesorëve përkatës.

Teksti duhet të shkruhet në gjuhën standarde shqipe, në përputhje me rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Përmbledhja e shkurtër e temës së diplomës (Rezymja) duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

UDHËZIMET TEKNIKE PËR HARTIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Punimi duhet të ketë të paktën 15 dhe jo më shumë se 50 faqe, duke përfshirë referencat. Duhet të shkruhet në letër të bardhë A4 (210 x 297 mm).

Konfigurimi:

Radhori 1.5

Madhësia e shkronjave 12 pikë tipografike

Lloji i shkronjave (Times New Roman CE).

Frenimi (skaji) majtas 3.5 cm

Frenimi (skaji) lartë 2.5 cm

Frenimi (skaji) poshtë 2.5 cm

Frenimi (skaji) djathtas 2.5 cm

Numërohen të gjitha faqet duke filluar nga hyrja, kurse numri shkruhet poshtë, në mesin e faqes.

ILUSTRIMET

Punimi mund të përfshijë dy lloje ilustrimesh dhe atë: tabela dhe figura (fotografitë, vizatimet, skemat, diagramet, histogramet, hartat, etj). Ilustrimet shënohen me numra arab me renditje sipas paraqitjes së tyre në punim dhe duke respektuar rregullar e referimit të literaturës (shih më poshtë specifikat e referencave). Ato vendosen krahas tekstit ku përshkruhen. Të gjitha figurat duhet të titullohen. Numrat dhe titujt e tabelave vendosen mbi tabelë ndërsa numrat dhe titujt e figurave vendosen nën figurë. Nëse ilustrimi nuk është kontribut origjinal i autorit është e nevojshme të specifikohet burimi (shih më poshtë specifikat e referencave).

SHKURTESAT

Me rastin e futjes së parë të ndonjë shkurtese në punim fillimisht duhet të shkruhet emërtimi i plotë i konceptit, dhe pastaj shkurtesa, e cila futet në kllapa. Më poshtë në tekst mund të përdoret vetëm shkurtesa. Në titullin e punimit nuk mund të përdoren shkurtesa, përveç nëse kuptimi i tyre është përgjithësisht i njohur.

Është e nevojshme të specifikohen të gjitha kuptimet për të cilat në punim do të përdoren shkurtesa dhe përmbledhja e të gjitha shkurtesave të përdorura në tekst duhet të përmblihet në faqen e gjashtë siq është specifikuar më poshtë.

LIDHJA DHE KOPERTINAT

Punimi i diplomës lidhet. Në shtyllën e lidhjes shtypet emri dhe mbiemri i autorit, viti i mbrojtjes dhe llogoja e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega përkatëse, emri i mentorit. Faqja e brendshme e kopertinave dhe faqja e parë e cila mbështet në kopertinë mbetet e pashkruar.

Kopertina e parë e punimit të lidhur dhe faqja e parë janë identike dhe duhet të përmbajnë:

- Llogoja e Universitetit të Prishtinës (pjesa e sipërme në qendër)
- Titulli i Universitetit të cilit i përket Fakulteti (pjesa e sipërme në qendër, Times New Roman 20, shkronja të mëdha)
- Emri i Fakultetit ku mbrohet punimi i diplomës (pjesa e sipërme në qendër, Times New Roman 18, shkronja të mëdha)

- Emrit i Degës përkatëse (pjesa e sipërme në qendër, Times New Roman 16, shkronja të mëdha)
- Titulli i punimit të diplomës (pjesa e mesme në qendër, Times New Roman 20, shkronja kapitale, bold)
- Emri dhe mbiemri i kandidatit, në pjesën e poshtme majtas (Times New Roman 14, shkronja të vogla)
- Emri dhe mbiemri i mentorit, në pjesën e poshtme djathtas (Times New Roman 14, shkronja të vogla)
- Vendi, muaji dhe viti i realizimit, pjesa e poshtme, mesi i faqes (Times New Roman 14, shkronja të vogla)
- Ngjyra e Kopertinës për studimet themelore duhet të jetë e kuqe (për studimet bachelor e gjelbërt).

FAQET HYRËSE

Faqja e parë është përmbajtësisht dhe teknikisht identike me kopertinën.

Faqja e dytë duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Punimi është bërë në (institucioni, instituti, enti, klinika, etj).
- Mentori (emrin dhe mbiemri, titullin akademik, institucioni)
- Punimi përfshin:(numri)..... faqe; (numri).....Tabela;.....(numri)..... Figura

Faqja e tretë është deklarata e kandidatit në lidhje me vërtetësinë e punimit të diplomës. Një shembull i kësaj deklarate është si në vijim: *“Deklaroj se kjo Temë e Diplomës është punimi im origjinal. E gjithë literatura dhe burimet tjera që i kam shfrytëzuar gjatë punimit janë të listuara në referenca dhe plotësisht të cituara”*.

Faqja e katërt është fakultative dhe aty mund të shkruhet parathënia, dedikimi apo falënderimet.

Prologu duhet të përfshijë informata relevante për studimin, si emri dhe shenja e projektit në kuadër të të cilit është kryer hulumtimi.

Faqja e pestë është përmbajtja. Përmbajtja përmban listën e të gjithë kapitujve dhe nënkapitujve me faqet ku të njëjtit fillojnë. Faqet shënohen me numra arabë dhe kanë shenjën e faqes ku fillojnë. Përrjashtim bën shtojca e cila, nëse ka të tillë, shënohet në përmbajtje pas jetëshkrimit dhe nuk shënohet me numër arabë.

Faqja e gjashtë përmban listën e shenjave dhe shkurtesave.

Faqet hyrëse (para abstraktit) shkruhen me numra romak dhe nuk numërohen në totalin e faqeve të punimit.

STRUKTURA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Konstrukt i punimit varet nga lloji i punimit. Varësisht nga natyra e punimit të Temës së Diplomës, rekomandohet që struktura e punimit të jetë si në vijim:

- 1. Abstrakti**
- 2. Hyrje**
- 3. Qëllimi i punimit**
- 4. Metodologjia (Subjektet dhe Metodat ose Materialet dhe Metodat)**
- 5. Rezultatet**
- 6. Diskutim**
- 7. Përfundimi**
- 8a. Rezyme**
- 8b. Summary**
- 9. Referencat**
- 10. CV e shkurtër e kandidatit**

INTEGRITETI AKADEMIK

Mbledhja e të dhënave

Në çdo hap të punimit të Temës së Diplomës, duhet të sigurohet mbrojtja e konfidencialitetit dhe ruajtja e anonimitetit të të dhënave personale të pjesëmarrësve të studimit. Mbledhja e të dhënave dhe informatave duhet të respektoj procedurat për mbrojtjen e të dhënave të pacientëve sipas kërkesave të SHSKUK.

Nëse në punim përfshihet pjesëmarrësi-subjekti, para fillimit të realizimit të punimit, duhet të sigurohet pëlqimi i Komitetit Etik. Gjithashtu është e domosdoshme të merret pëlqimi i pjesëmarrësit për ta realizuar punimin. Në rastet tjera të caktuara mentori duhet të shqyrtojë me kandidatin nevojën për aprovimin e mbledhjes së të dhënave nga Komisioni Etik i Fakultetit të Mjekësisë. Në këtë proces kandidati do të përkrahet nga ana e mentorit.

Vërtetësia e të dhënave të grumbulluara dhe materialit tjetër të përdorur për Temat e Diplomës është në përgjegjësi të kandidatit që punon Temën e Diplomës.

Plagjiarizmi

Plagjiarizmi do të monitorohet me rreptësi gjatë gjithë procesit të punimit të Temës së Diplomës. Plagjiati ndodh kur puna ose prona e një studenti apo individi tjetër paraqitet si punë vetanake pa referim adekuat. Prandaj, Temat e Diplomës do t'i nënshtrohen detektimit për plagjiarizëm nga ana e mentorit të temës. Me rastin e dorëzimit të Temës së Diplomës, kandidati është i obliguar që të jep një deklaratë që adreson çështjen e plagjiarizmit.

Literatura

Studentët gjatë shkrimit të Temës së Diplomës duhet respektuar standardet për citime dhe respektim të të drejtave autoriale .

Referencat ndodhen në fund të punimit të Temës së Diplomës dhe pasqyrojnë burimet që autori i ka përdorur gjatë përgatitjes së punimit. Referencat radhiten ashtu si janë paraqitur në tekst, sipas rregullave të International Committee of Medical Journal Editors (<http://www.icmje.org/>) (i njohur më parë si stili *Vancouver*). Shembuj specifikt të referencave mund të gjenden në: www.nlm.nih.gov/bsd/uniform_requirements.html.

Revistat duhet të paraqiten me shkurtesat që përdoren në Index Medicus (www.nlm.nih.gov). Rregullat e citimit i merr çdo kandidat bashkë me udhëzimet për hartimin dhe përgatitjen e punimit të diplomës në Shërbimin e Studentëve.



Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës

VLERËSIMI I TEMËS SË DIPLOMËS

Shtojcë e udhëzuesit për hartimin e punimit të temës së diplomës për studime themelore



FAKULTETI I MJEKËSISË

Rubrika e vlerësimit të temave të diplomës

Çka është rubrika e vlerësimit?

Rubrika e vlerësimit është një instrument i dizajnuar nga Komisioni i Studimeve i Fakultetit të Mjekësisë. Kjo rubrikë është dizajnuar me qëllim të përcaktimit të kritereve themelore gjatë vlerësimit të studentëve me rastin e prezantimit të punës së tyre seminarike apo me rastin e mbrojtjes së temave të diplomës. Rubrika e vlerësimit mundëson vendosjen e vlerës numerike në raport me përshkruesit specifik të performancës së studentëve. Rubrika e vlerësimit mundëson një llogaritje më objektive të poentimit dhe notimit të studentëve gjatë prezantimit të punës së tyre. Duke siguruar një uniformitet dhe standard ndërmjet vlerësuesve të ndryshëm të të njejtit student, rubrika e vlerësimit gjithashtu ndikon pozitivisht në aspektin e mbrojtjes së integritetit akademik gjatë procesit të vlerësimit të studentëve.

Si të përdoret rubrika e vlerësimit?

Rubrika posedon nivele të ndryshme të arritjes së aftësisë së studentit dhe çdo nivel poentifikohet. Nivelet e arritjes së aftësisë janë ndarë në katër kategori: shkëlqyeshëm (maksimum 10 pikë), mjaftueshëm (maksimum 7 pikë), pamjaftueshëm (maksimum 5 pikë) dhe dobët (0 pikë). Studenti duhet të vlerësohet për punën e dorëzuar me shkrim (p.sh. temën e lidhur të diplomës) dhe punën e prezantuar (dmth mbrojtjen e temës së diplomës). Puna e prezantuar me shkrim akumulon gjithsej 50 pikë ndërsa mbrojtja e temës edhe 50 pikë tjera. Nota përfundimtare kalkulohet pas mbledhjes së poeneve të punës së prezantuar me shkrim dhe mbrojtjes publike të temës nga ana e kandidatit. Secili anëtarë i komisionit të mbrojtjes së temës së diplomës vlerëson kandidatin në mënyrë të pavarur. Në rast se ka diskrepancë ndërmjet vlerësuesve me më shumë se 10 pikë, atëherë vlerësimi duhet të rishqyrtohet derisa kjo diskrepancë të jetë nën 10 pikë. Nota përfundimtare e kandidatit është mesatarja e vlerësimeve nga tre anëtarët e komisionit të mbrojtjes së temës së diplomës.



A) POENTIMI I TEMËS SË DORËZUAR TË DIPLOMËS

Kandidati: _____; ID: _____; Data ____/____/____

Vlerësimi	Shkëlqyeshëm (10)	Mjaftueshëm (7)	Pamjaftueshëm (5)	Dobët (0)	Pikë
Abstrakti, hyrja dhe qëllimet	Abstrakti shkruar saktësisht dhe strukturuar shkëlqyeshëm. Hyrja e punimit përmbledh shkëlqyeshëm literaturën ekzistuese dhe relevante. Nuk ka shkrim të panevojshëm. Qëllimet janë të karta dhe relevante si dhe mbështesin metodologjinë dhe rezultatet. ☐	Abstrakti ka hapësirë për përmirësim. Hyrja e punimit përmbledh literaturë ekzistuese relevante por edhe jo-relevante. Qëllimet janë të karta por jo edhe relevante. Qëllimet pjesërisht mbështesin metodologjinë dhe rezultatet. ☐	Abstrakti ose hyrja ose qëllimet e punimit nuk janë përfshirë. Hyrja e punimit përmbledh literaturë ekzistuese jo-relevante. Qëllimet nuk janë të karta dhe relevante. ☐	Mungon abstrakti, hyrja, qëllimet ☐	/10
Metodologjia	Është përfshirë në detaje dizajnimi i punës (hulumtim shkencor, rishikim i literaturës apo studim rasti). Është përshkruar mostra dhe analiza statistikore detajisht dhe saktësisht. ☐	Është përfshirë në pak detaje dizajnimi i punës (hulumtim shkencorë, rishikim i literaturës apo studim rasti). Nuk është përshkruar mostra dhe analiza statistikore detajisht dhe saktësisht. ☐	Nuk është përfshirë dizajnimi i punës (hulumtim shkencorë, rishikim i literaturës apo studim rasti). Nuk është përshkruar mostra dhe analiza statistikore fare. ☐	Mungon metodologjia ☐	/10
Rezultatet, diskutimi dhe konkluzat	Rezultatet janë gjithmonë të karta dhe të sakta. Janë përdorur figura/tabela relevante për të përshkruar rezultatet. Rezultatet janë në përputhje me metodologjinë dhe qëllimet e punimit. Diskutimi dhe konkluzat janë përmbledhur shkëlqyeshëm dhe janë në përputhje me rezultatet dhe qëllimet e punimit. ☐	Rezultatet janë kryesisht të karta dhe të sakta. Janë përdorur figura/tabela relevante për të përshkruar rezultatet. Rezultatet janë në përputhje me metodologjinë dhe qëllimet e punimit. Diskutimi dhe konkluzat janë përmbledhur mire por jo gjithmonë në përputhje me rezultatet dhe qëllimet e punimit. ☐	Rezultatet nuk janë të karta dhe ka gabime. Mungojnë figura/tabela në rastet kur këto janë të domosdoshme për të përshkruar rezultatet. Rezultatet nuk janë në përputhje me metodologjinë dhe qëllimet e punimit. Mungojnë konkluzat. ☐	Mungojnë rezultatet, diskutimi dhe konkluzat ☐	/10
Referencimi	Respektohet në përpikëri stili Vancouver i referimit. Shumica e referencave janë të cilësisë së lartë, kredibile dhe relevante. ☐	Respektohet stili Vancouver i referimit. Ka referenca që nuk janë kredibile dhe të cilësisë së lartë. ☐	Nuk respektohet stili Vancouver i referimit dhe ka nevojë për shumë intervenim për të arritur deri te referimi i sakt. ☐	Studenti nuk ka referuar fare. ☐	/10
Gramatika, shkrimi, respektimi i udhëzuesit së temës	Pa gabime gramatikore dhe shkruar shkëlqyeshëm. Shkrimi i rrjedhshëm dhe i lehtë për tu kuptuar. Udhëzuesi respektohet plotësisht. ☐	Pak gabime gramatikore. Shkrimi i rrjedhshëm dhe lehtë i kuptueshëm. Udhëzuesi respektohet kryesisht. ☐	Disa gabime gramatikore. Shkrimi jo lehtë i kuptueshëm. Udhëzuesi respektohet pjesërisht. ☐	Shumë gabime gramatikore Udhëzuesi nuk respektohet. ☐	/10
GJITHSEJ PIKËT NGA PUNIMI I DORËZUAR I TEMËS SË DIPLOMËS:					/50

B) POENTIMI I PREZANTIMIT TË TEMËS SË DIPLOMËS

Kandidati: _____; ID: _____; Data ____/____/____

Vlerësimi	Shkëlqyeshëm (10)	Mjaftueshëm (7)	Pamjaftueshëm (5)	Dobët (0)	Pikë
Prezantimi	Prezantim shumë i kjartë me konfidencë, dhe me entuziazëm. Prezantimi kuptohet lehtë dhe studenti ka dëshmuar njohuri të avansuar të problematikës së prezantuar. Prezantimi është i sakt me kohë. ☐	Prezantim i kjartë dhe kuptohet lehtë nga audienca. Mungon konfidenca dhe entuziazmi. Prezantimi ka tejkaluar jo më shumë se 5 minuta kohën e alokuar. ☐	Prezantimi nuk është i kjartë dhe dëgjohet me vështirësi. Prezantuesi nuk shikon drejt audiencës dhe përdorë material ndihmues për të lexuar prezantimin. Prezantimi është ndërprerë për shkak të kohës tepër të gjatë (mbi 10 minuta pas afatit të dhënë kohor) ☐	Nuk ka prezantim fare. Prezantuesi nuk është paraqitur fare. Prezantimi është më pak se 5 minuta ☐	/10
Prapavija, formatimi dhe grafika	Prapavija e duhur dhe nuk pengon leximin. Formatimi, fonti të shkëlqyeshme dhe lexueshmëria e lehtë. Janë përdorur grafika të shkëlqyeshme që e mbështesin mirë përmbajtjen (figura, tabela etj.) ☐	Prapavija e duhur dhe nuk pengon leximin. Formatimi, fonti kryesisht të mirë dhe lexueshmëria kryesisht e lehtë. Kandidati ka përdorur grafika por të cilat jo gjithmonë e mbështesin përmbajtjen (figura, tabela etj.) ☐	Prapavija, formatimi dhe fonti i shkronjave pengojnë leximin. Kandidati ka përdorur grafika pa nevojë të cilat nuk e mbështesin përmbajtjen (figura, tabela etj.) ☐	Prapavija, formatimi dhe grafika nuk e mbështesin përmbajtjen e prezantimit ☐	/10
Përgjigja në pyetjet	Përgjigje të shkëlqyeshme në të gjitha pyetjet dhe demonstrim i njohurive të avansuara të çështjeve të ngritura ☐	Përgjigje të kënaqshme në shumicën e pyetjeve dhe demonstrim i njohurive të mjaftueshme të çështjeve të ngritura ☐	Përgjigje jo të mira në pyetjet e parashtruara dhe nuk ka demonstrim të njohurive të mjaftueshme të çështjeve të ngritura ☐	Kandidati nuk është përgjigjur fare ☐	/10
Efektiviteti dhe argumentimi	Prezantimi plotësisht mbuloi problematikën e studiuar përbrenda prezantimit. Argumentet janë logjike, mirë të thurrura dhe dëshmojnë njohuri të shkëlqyeshme të temës ☐	Prezantimi nuk mbulon plotësisht problematikën e studiuar. Ka hapësira për përmirësim në logjikën e argumentimit por në përgjithësi dëshmohet njohuri e mirë e tematikës së studiuar ☐	Prezantimi nuk mbulon problematikën e studiuar. Ka shumë hapësirë për përmirësim në logjikën e argumentimit. ☐	Problematika e temës nuk mbulohet fare dhe mungon argumentimi ☐	/10
Gramatika, dhe referimi	Prezantimi pa gabime gramatikore dhe shkruar shkëlqyeshëm. Referimi respektohet plotësisht ☐	Pak gabime gramatikore. Shkrimi i rrjedhshëm dhe lehtë i kuptueshëm. Referimi respektohet pjesërisht. ☐	Disa gabime gramatikore. Shkrimi jo lehtë i kuptueshëm. Referimi kryesisht nuk respektohet ☐	Shumë gabime gramatikore. Prezantimi vështirë kuptohet. ☐	/10
GJITHSEJ PIKËT NGA PUNIMI I DORËZUAR I TEMËS SË DIPLOMËS:					/50



FAKULTETI I MJEKËSISË

SEKSIONI QË PLOTËSOHET NGA KRYETARI I KOMISIONIT

Anëtarët e Komisionit	Pikët nga Seksioni A	Pikët nga Seksioni B	Gjithsej pikët	Nënshkrimi i anëtarëve të Komisionit
1.				
2.				
3,				
PIKËT TOTALE NGA MESATARJA E VLERËSIMIT TË TRE ANËTARËVE TË KOMISIONIT:				
NOTA PËRFUNDIMTARE KALKULUAR NGA PIKËT TOTALE				





FAKULTETI I MJEKËSISË

RAPORT I VLERËSIMIT TË VAZHDUESHËM TË STUDENTËVE

LËNDA: Zgjedhe lëndën

DEGA: Zgjedhe degën

DATA: Zgjedhe datën

VITI AKADEMIK: Zgjedhe vitin

SEMESTRI: Zgjedhe semestrin

1. LLOJET E VLERËSIMEVE

Llojet e vlerësimeve të lëndës:	Data e realizimit të vlerësimit:
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën
Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin	Kliko këtu dhe zgjedhe datën

2. INTEGRITETI AKADEMIK GJATË VLERËSIMIT

a) Integriteti themelorë akademik

Mbikqyren të gjitha vlerësimet nga Profesori/Asistenti

Po ☐ Jo ☐ EPA* ☐

Verifikohet identiteti i studentëve gjatë vlerësimit

Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Përdoren metoda që parandalojnë plagjiazmin

Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

*EPA=e pa-aplikueshme

DATA: Zgjedhe datën

VITI AKADEMIK: Zgjedhe vitin

SEMESTRI: Zgjedhe semestrin

b) Vlerësimi i drejtë i studentëve

Vlerësimet koordinohen dhe pajtohen nga të gjithë mësimezhënësit e lëndës Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Vlerësimet rishikohen dhe kanë të dizajnuara çelësin e pyetjeve Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Është caktuar bashkëvlerësuesi nga e njejtë lëndë (kur lënda ligjrohet nga më shumë se një Profesor) Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Bashkëvlerësuesi ka rishikuar pyetjet dhe çelësin e pyetjeve para vlerësimit të studentit Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Vlerësimi është bazuar në literaturë të përditësuar dhe të raportuar në syllabusin e lëndës Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

c) Regjistrimi i notimit të studentëve

Notat janë regjistruar në SEMS brenda afatit kohorë Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Ndryshimi notave në SEMS është bërë brenda afatit kohorë Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Notat e studentëve janë regjistruar në librin e protokolit Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

d) Moderimi i vlerësimeve

Studentët janë njoftuar në syllabus dhe në fillim të semestrit për komponentët e vlerësimit të vazhdueshëm të lëndës Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Studentët janë të njoftuar me kriteret e notimit për të gjitha komponentet e vlerësimit të lëndës Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Gjatë vlerësimit të punës seminarike përdoren rubrikat e vlerësimit për të siguruar vlerësim konsistent Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Në rastet kur studenti arrinë pikë në kufi të notës tjetër, rivlerësohet testi/provimi Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

Në rastet kur studenti vlerësohet nga >2 vlerësues dhe ka diskrepancë të notimit, testimi rivlerësohet Po ☐ Jo ☐ EPA ☐

PROFESORI I LËNDËS: Kliko këtu dhe shkruaj emrin dhe mbiemrin e bartësit të lëndës



FAKULTETI I MJEKËSISË
RAPORT DYJAVORË I MONITORIMIT TË MËSIMIT

DEGA: Zgjedhe degën

VITI AKADEMIK: Zgjedhe vitin

SEMESTRI: Zgjedhe semestrin

KATEDRA: Zgjedhe katedrën

PERIUDHA E RAPORTIMIT: JAVA I Zgjedhe fillimin e javës I **dhe JAVA II** Zgjedhe fillimin e javës II

Sqarim: Ilogaritja e javëve fillon nga dita e parë e semestrit ndërsa raportimi bëhet në interval dyjavore

REALIZIMI I MËSIMIT (LIGJERATA)

LËNDA E KATEDRËS	MËSIMDHËNËSI	JAVA I	JAVA II
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐

REALIZIMI I MËSIMIT (USHTRIME)

LËNDA E KATEDRËS	ASISTENTI	JAVA I	JAVA II
Zgjedhe lëndën	kliko dhe shkruaj emrin	☐	☐
